

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
- DELEGACIONI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË
UNIONIN INTERPARLAMENTAR

RAPORT
PËR PJESËMARJEN NË KUVENDIN e 111-të TË UNIONIT
INTERPARLAMENTAR,
të mbajtur në Gjenevë, më 28 shtator 2004, Konfederata e Zvicrës

Shkup, tetor 2004

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
<u>KUVENDI 111 E UIP</u>	2
Pikë plotësuese urgjente e rendit të ditës	3
Puna e komisioneve.....	4
Miratimi i rezolutave të Kuvendit 111 të UIP.....	8
Ndryshime dhe plotësime të Statutit të Unionit.....	8
MBLEDHJA E 175 E KËSHILLIT DREJTUES TË UIP	9
Anëtarësimi në Union.....	9
Situata financiare e Unionit dhe buxheti për vitin 2005.....	9
Bashkëpunim me sistemin e Kombeve të Bashkuara	9
Konferenca dhe mbledhje të speciale.....	10
Raporte për punën e Komisioneve dhe trupave tjera të Unionit.....	10
Mbledhjet e ardhme interparlamentare.....	10
PJESËMARRJA NË PUNËN E TRUPAVE, FORMAVE DHE AKTIVITETEVE TË UNIONIT	11
Takim i Komitetit Koordinues të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim të Mesdheut (CSCM).....	11
Grupi gjeopolitik “ Dymbëdhjetë plus”.....	12
Diskutimi panel për sfidat me të cilat ballafaqohet e drejta humanitare ndërkombëtare.....	12
Mbledhjet e shoqatës së sekretarëve të përgjithshëm të parlamentarëve....	13
Aktivitetet tjera në rrjedhë të Kuvendit.....	14
SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE	14
REZULATAT E MIRATUAR	15
Situata alarmante në Irak dhe nevoja për aktivitet parlamentarë që do të kontribuojë për kthimin e paqes dhe sigurisë në vend.....	15
Roli i Parlamenteve në forcimin e regjimeve multilaterale për moszgjerimin e armatimit dhe për çarmatim, në dritën e sfidave të reja të sigurimit.....	18
Roli i parlamenteve në mbrojtjen e biodiversitetit	25
Peking + 10: evaulimi nga perspektiva parlamentare.....	32

HYRJE

Kuvendi i Unionit parlamentar (KIU) e mbajti mbledhjen e 111 të rregullt të vet pre 28 shtator deri më 1 tetor 2004, në Qendrën ndërkombëtare për konferenca në Gjenevë, Konfederata e Zvicrës. Në Kuvendin e 111 të KIU mori pjesë Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që e përbëjnë deputetët: zonja Angellka Peeva-Llaurençiq, kryesuese e Delegacionit, zonja Karolina Ristova, z. Çedomir Krlevski dhe z. Ismet Ramadani, anëtarë të Delegacionit, si dhe zonja Roska Georgievska, zëvendës-sekretare e përgjithshme e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, zonja Anita Ognjanovska, udhëheqëse e Seksionit dhe zonja Biljana Ognenovska, këshilltare për bashkëpunim multilateral. Në një pjesë të aktiviteteve mori pjesë edhe zonja Dragica Zafirovska, ushtruese e detyrave në Misionin e përhershëm të Republikës së Maqedonisë në Gjenevë.

KUVENDI I 111-të I UIP

Kuvendin e njëqind e njëmbëdhjetë të Unionit Interparlamentar e hapi z. Serxho Paez Verdugo, senator nga Çile dhe kryetari i KUI. Zoti Verdugo, u zgjodh kryetar i Kuvendit, kurse z. Rudi Sall, deputet nga Franca dhe nënkryetar për Komitetin Ekzekutiv të KUI u zgjodh nënkryetar i Kuvendit.

Në Kuvendin morën pjesë 112 delegatë të parlamenteve 1) (nga 140 parlamente-anëtare të Unionit). Nga anëtarët shoqëruese, në punën e

1) Austria, Algjeria, Andora, Angola, Argjentina, Azerbexhani, Bangladeshi, Bahrein, Belgjika, Belorusia, Benini, Bollivia, Bosnja e Hercegovina, Bregu i Fildishtë, Bullgaria, Burkina Faso, Burundi, Venezuela, Vietnami, Gaboni, Gana, Guatemala, Guinea, Gjermania, Greqia, Danimarka, Republika Demokratike e Kongos, Egjipti, Ekuador, El Salvador, Ermenia, Estonia, Zimbabve, Izraeli, India, Indonezia, Irani (Republika Islamike), Irlanda, Islanda, Italia, Japonia, Jordania, Afrika Jugore, Kanada, Kazakistani, Kenia, Kina, Qiproja, Kongoja, Kuba, Kuvajti, Laos, Latvia, Liban, Xhamaharia Arabe e Libisë, Lituania, Lihtenshtajn, Luksenburg, Mavricius, Malajzia, Mali, Maroko, Meksika, Monako, Mongolia, Namibia, Nepali, Nigeria, Zelanda e Re, Norvegjia, Republika e Bashkuar e Tanzanisë, Mbretëria e Bashkuar, Emiratet e Bashkuara Arabe, Pakistani, Polonia, Portugalia, Republika e Koresë, Republika e Maqedonisë, Rumania, Roanda, Federata Ruse, San Marino, San Tome dhe Principe, Arabia Saudite, Senegali, Singapuri, Republika Arabe e Sirisë, Sllovakia, Sllovenia, Serbia dhe Mali I Zi, Sudani, Surinam, Tajlanda, Togo, Tunizia, Turqia.

konferencës morën pjesë asociacionet parlamentare regjionale 2), e në cilësi të vëzhguesve-delegacione të parlamenteve të Palestinës dhe të Moldivës, si dhe përfaqësues të më shumë trupave dhe agjencive të specializuara të OKB 3) dhe përfaqësues tjerë të organizatave ndërkombëtare dhe regjionale 4), të organizatave joqeveritare 5) etj.

Në mbledhjen morën pjesë 989 delegatë prej të cilëve 453 anëtarë të parlamenteve. Nga delegatët-anëtarë të parlamenteve, 28 ishin bartës të funksionit kryesues, 26 bartës të funksionit nënkryesues dhe 130 gra parlamentare (28,7%).

PIKA PLOTËSUESE URGJENTE E RENDIT TË DITËS

Në pajtim me Statutin, Kuvendi i Unionit Interparlamentar u deklarua për plotësimin e rendit të ditës me pikë plotësuese urgjente. U parashtruan tre propozime për plotësim të rendit të ditës:

- 1) Nga Afrika Jugore: "Roli i parlamentarëve në shqyrtimin e sfidave të sigurisë me të cilat ballafaqohet kontinenti i Afrikës, me vështrim të veçantë të krizës humanitare dhe të sigurisë së regjionin Darfur në Sudan";
- 2) Nga Sudani: "Roli i parlamentarëve në përkrahjen e paqes dhe zgjidhjen e konflikteve në Afrikë, me vështrim të problemit në Darfur" dhe
- 3) Nga Republika Islame e Iranit me përkrahje të grupit gjeopolitik Azi-Pacifik: Gjendja alarmante në Irak dhe nevoja për aksion parlamentar që do të kontribuojë për rivendosjen e paqes dhe sigurisë në vend".

Uganda, Ukraina, Hungaria, Uruguaji, Filipinet, Finlanda, Franca, Holanda, Republika Çeke, Çile, Suedia, Spanja dhe Sri Lanka.

2 Parlamenti i Andeve, Parlamenti Evropian, Parlamenti Latin0-amerikan, Kuvendi parlamentar i Këshillit të Evropës dhe Parlamenti i Bashkësisë Ekonomike të Shteteve të Afrikës Perëndimore.

3 Kombet e bashkuara, Organizata Ndërkombëtare për Punë (ILO), Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara të OKB për refugjatë (UNHCR), Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Fondi për Fëmijë të OKB (UNICEF), Vullnetarët e OKB (UNV), Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Organizata Tregtare Botërore (WTO).

4 Unioni Afrikan, Organizata Ndërkombëtare për Migracione (IOM), Liga e Shteteve Arabe , Unioni Interparlamentar i Arabisë (AIPU), Unioni Parlamentar i Afrikës (APU), Kuvendi i Unionit të Evropës Perëndimore (AWEU), Shoqata e Parlamenteve Evropiane për Afrikën (AWEPA), Këshilli Evropian Konsultativ, Kuvendi Parlamentar i Unionit të Bjellorusisë dhe Federatës Ruse, Shoqata Parlamentare për Bashkëpunim Euro-arab (PAEAC), Unioni Parlamentar i Vendeve të Organizatës së Konferencës Islamike (PUOICM) dhe Organizata për ndalimin e armatim kimik (OPSW).

5 Amnesty International, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënë.

Propozimet parashtruara të Afrikës Jugore dhe Sudanit u tërhoqën në favor të propozimit të Iranit. Për këtë reagoi delegacioni i Kanadasë, e cila duke theksuar se nuk është kundër pikës së propozuar, shprehu keqardhje se Kuvendi i KUI nuk debaton për gjendjen shqetësuese humanitare në regjionin Darfur.

Pika e propozuar nga Republika Islamike e Iranit u miratua njëzëri nga Kuvendi, e pastaj u formua komision teknik për përgatitjen e Propozim-rezolutës, përbërë nga përfaqësues të grupeve gjeopolitike.

Debatin për pikën plotësuese urgjente, që u mbajt më 29 shtator 2004, e hapi kryetari i Kuvendit z. Serxho Paez Verdugo, kurse në të morën pjesë 35 oratorë (34 delegacione parlamentare dhe një vëzhgues). Debatin e përcollën deputetët zonja Angellka Peeva Laurençiq dhe z. Ismet Ramadani. Komisioni teknik, i përbërë nga parlamentarë nga Benini, Venezuela, Egjipti, Irani, Kanadaja, Kuvajti, Portugalia dhe Franca, përgatiti Propozim-rezolutë dhe ia parashtrori për miratim Kuvendit të KUI.

PUNA E KOMISIONEVE

Komisioni i parë i përhershëm për paqe dhe siguri ndërkombëtare në mbledhjet e mbajtura më 28 dhe 30 shtator 2004, diskutoi për pikën e rendit të ditës së Kuvendit: “Roli i parlamentarëve në përforcimin e regjimeve multilaterale për moszgjerimin e armëve dhe për çarmatim, në dritën e sfidave të reja siguruese”. Në punën e Komisionit merrte pjesë anëtari i delegacionit z. Ismet Ramadani.

Komisioni diskutoi për raportin dhe Propozim-rezolutën përgatitur nga referuesit zonja Salva Damen Masri, senatore nga Jordania dhe z. Xhon Vilkinson, deputet nga Britania e Madhe, si dhe për amendamentet e Rezolutës së parashtruar në afatin e paraparë me statut 6). Në diskutim morën pjesë 56 diskutues nga 47 vende dhe dy organizata ndërkombëtare, ndër të cilët edhe anëtari i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë z. Ismet Ramadani.

Në kornizë të diskutimit të vet z. Ramadani theksoi se në kushtet e ndryshimeve globale në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar dhe veçmas pas sulmeve terroriste ndaj SHBA të 11 shtatorit 2001, çështja me ploriferimit të armëve, para se gjithash armët për zhdukje në masë, ngrihet në shkallë të kërcënimit më të madh për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare. Ai vlerësoi se parlamentarët mund të luajnë rol kyç në përmirësimin e regjimit për kontrollin e plotësimit të detyrimeve që dalin nga instrumentet ndërkombëtare për zhdukjen e ploriferimit të armëve, univerzalizimit të tyre, si dhe në afirmimin e iniciativave të reja siguruese.

6) Në pajtim me statutin dhe parimet e Unionit Interparlamentar (rregulli 17.1 nga Rregullat e Kuvendit dhe rregulli 12.2 nga Rregullat e komisioneve ekzistuese), amendamentet e propozim-rezolutave të përgatitura nga referuesit duhet t'i dërgohen Sekretariatit të KUI më së voni një javë para hapjes së Kuvendit.

Deputeti Ismet Ramadani theksoi se Republika e Maqedonisë i mbështet të gjithë iniciativat për luftë kundër proliferimit të armëve, i zbaton detyrimet e ndërmarra nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe nuk planifikon zhvillim, furnizim, grumbullim dhe përdorim të armëve për shkatërrim në masë. Njëkohësisht, ai informoi për implementimin e detyrimeve që dalin nga regjimet multilaterale që janë përmendur në raportin e parashtruar: Marrëveshjen për mospërhapjen e armës nukleare (NPT), Konvencionin për armë nukleare (CWC), Konvencionin për ndalim të zhvillimit, prodhimit dhe

grumbullim të armëve biologjike dhe toksike dhe për shkatërrimin e tyre (BTWC), Marrëveshjen për ndalimin të gjitha testeve nukleare (CTBT), dhe etj. Megjithatë, z. Ramadani theksoi se në prill të vitit 2004 ishin bërë ndryshime të Ligjit penal me të cilin u vendosën sanksione për veprat e reja penale lidhur me keqpërdorimin e armës kimike dhe biologjike.

Në lidhje me regjimin e kontrollit të teknologjisë raketore (MTCR) ai theksoi se Republika e Maqedonisë u përmbahet Orietimeve për transferimin e teknologjisë së ndjeshme dhe Aneksin për pajisje, softuer dhe teknologji, me ç'rast vuri në dukje se po përgatiten ndryshime dhe plotësime gjithëpërfshirëse të normativës ekzistuese nacionale, për shkak të përshtatjes me standardet e përcaktuara ndërkombëtare për kontrollimin e eksportit të kësaj pajisjeje.

Pas debatit u formua Komision teknik i përbërë prej parlamentarësh nga Algjeria, Burkina Faso, Gana, Greqia, India, Izraeli, Jordania, Kanadaja, Kina, Federata Ruse, Siria dhe Kili. Në punën e komisionit teknik morën pjesë edhe dy referues nga Jordania dhe Britania e Madhe.

Projekt-rezoluta e përgatitur nga komisioni teknik u shqyrtua dhe miratua në mbledhjen e komisionit më 30 shtator 2004, me ç'rast dy delegacione i bënë vërejtje tekstit të propozuar. Në mbledhje gjithashtu, u caktuan tema për debat në Komisionin e parë për Kuvendin 112 dhe 113 të KUI. Anëtarët e Komisionit vendosën që Kuvendit t'ia propozojnë temat në vijim për futje në rendin e ditës në kuvendet në vijim:

- për Kuvendin e 112: "Rolin i parlamenteve për vendosjen dhe funksionim të mekanizmave përkatës për miratimin e vendimeve gjyqësore dhe dënimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, gjenocidit dhe terrorizmit, me qëllim që të njëjtit të mos ngelin pa dënuar", dhe

- për Kuvendin 113: "Aktiviteti dhe bashkëpunimi i përbashkët i parlamenteve dhe medimeve për informimin e mendimit publik, veçmas për konfliktet e armatosura dhe luftën kundër terrorizmit".

Në Komisionin e dytë të përhershëm për zhvillim të përhershëm, financime dhe tregti më 29 dhe 30 shtator 2004 u realizua debat për pikën e katërt të rendit të ditës: "Roli i parlamenteve në mbrojtjen e biodiversitetit". Në punën e Komisionit mori pjesë deputeti Çedomir Krlevski.

Komisioni shqyrtoi raportin dhe propozim-rezolutën e parashtruar nga referuesit, amendamentet e parashtruara si dhe informacionin e përgatitur nga Sekretariati i Konventës për biodiversitet.

Në diskutim morën pjesë 47 folës nga 42 vende dhe organizata ndërkombëtare. Në diskutimin e tij, anëtari i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Çedomir Krlevski theksoi se njerëzit, si pjesë e pandarë e ekosistemit global, janë të vetmit që mund dhe patjetër duhet të ndikojnë mbi mbijetesën e tij. Ai theksoi se rreziku nga degradimi i llojllojshmërisë biologjike është njëkohësisht edhe rrezik për sistemin themelor, që e mban jetën e planetit tonë. Duke nënvizuar se ndryshimet globale në ambientin jetësor tregojnë ndikime të rëndësishme mbi resurset

natyrore dhe funksionimin e ekosistemeve, z. Krlevski vuri në dukje domosdoshmërinë e ndërmarrjes së aksionit të koordinuar në nivel lokal, regjional dhe nacional, për preventivë, zvogëlim dhe zbutje të ndikimeve të dëmshme mbi llojlojshmërinë biologjike.

Deputeti Çedomir Krlevski theksoi se Republika e Maqedonisë dallohet me llojlojshmëri të mëdha biologjike, karakteristikat themelore të së cilave janë pasuria dhe heterogjeniteti i llojeve dhe ekosistemeve dhe theksoi se sipas analizave për llojlojshmërinë biologjike të vendeve të veçanta në Evropë, Maqedonia gjendet në kreun e listës së shteteve të njohura si "European Hotspot".

Ai i bëri një vështrim Strategjisë nacionale për mbrojtjen e llojlojshmërisë biologjike dhe Planit aksional për realizimin e saj, si dhe Ligjit për mbrojtjen e natyrës, i cili ka për qëllim që të kontribuohet në ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe faunës dhe florës së egër. Në të njëjtën kohë z. Krlevski theksoi se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i ratifikon të gjitha konventat relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe shumëllojshmërisë biologjike ndërmjet tjerash edhe konventat nga Berna, Parisi, Rioja, Ramsari, Uashingtoni, Boni etj.

Komisioni teknik i përbërë prej deputetësh nga Algjeria, Japonia Malajzia, Nigeria, Mbretëria e Bashkuar, Rumania, Federata Ruse, Arabia Saudite, Sudani, Uruguai dhe Zvicra shqyrtoi mbi 100 amendamente të rezolutës të parashtruara nga 15 shtete anëtare, me ç'rast miratoi 57 amendamente (në tërësi ose me ndryshime të vogla).

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator, Komisioni i dytë i përhershëm shqyrtoi tekstin e konsoliduar të propozim-rezolutës dhe miratoi tre amendamente plotësuese, me ç'rast rezoluta u përkrah me konsensus. Në mbledhje, gjithashtu, u përcaktuan temat për diskutim në Komisionin e dytë për Kuvendin 112 dhe 113 të KUI:

- për Kuvendin e 112: "Roli i parlamenteve për vendosjen e novacioneve financiare ndërkombëtare dhe mekanizmave tregtarë që do të mundësojnë zgjidhjen e problemit me borxhet dhe realizimin e qëllimeve zhvilluese të mileniumit", dhe
- për Kuvendin e 113: "Migrime dhe zhvillim".

Komisioni i tretë i përhershëm për demokraci dhe të drejtat e njeriut në mbledhjet e mbajtura më 28 dhe 30 shtator diskutoi për pikën e pestë të rendit të ditës së Kuvendit: "Pekin + 10: Evaluimi nga perspektiva parlamentare". Me Komisionin kryesoi zonja Rebeka Kadaga nga Uganda, me ç'rast u mbajtën dy mbledhje. Në punën e Komisionit të tretë të përhershëm mori pjesë deputetja Karolina Ristova.

Komisioni diskutoi lidhur me raportin dhe propozim-rezolutën e përgatitur nga referuesit zonja Margaret Mensa-Viliams nga Namibia dhe z. Jozef Filip Vinkler nga Gjermania, si dhe lidhur me amendamentet e Projekt-rezolutës së parashtruar prej delegacioneve nga Belgjika, Burkina Faso,

Kanadaja, Kuba, Egjipti, India, Japonia, Norvegjia, Rumania, Suedia dhe Britania e Madhe.

Në debat morën pjesë 59 diskutues nga 47 shtete dhe dy organizata ndërkombëtare, ndërmjet tjerash edhe anëtarë i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë zonja Karolina Ristova.

Në suazat e diskutimit të saj zonja Ristova theksoi se në prag të 10-vjetorit të Konferencës së Pekinit, në Republikën e Maqedonisë ka përmirësime të rëndësishme në implementimin e Agjendës së Pekinit. Ajo diskutimin e saj e orientoi në çështjen e emancipimit të grave në politikën para së gjithash shikuar nga dimensionin parlamentar, duke nënvizuar se këtu ndryshimet janë më dukshme. Në të vërtetë, zonja Ristova theksoi se në krahasim me zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 1994 (do të thotë para Konferencës së Pekinit), ku numri i grave ishte vetëm 3,3 %, pas zgjedhjeve të 2002 gratë në Parlamentin e Maqedonisë janë përfaqësuar me 18,3%. Këtu ka ndikim, gjithsesi edhe platforma e Pekinit për kyçjen e numrit më të madh të grave në politikë, si dhe bashkëpunimi dhe përpjekjet e grave në politikë dhe në sektorin joqeveritar.

Deputetja Ristova në diskutimin e vet i njoftoi pjesëmarrësit se prania e grave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë është më tepër se evidente. Ajo nënvizoi se gratë në Parlamentin e Maqedonisë janë bartëse të funksioneve të larta, duke theksuar se nga dy nënkryetarët e Kuvendit njëri është grua; janë kryetare të pesë komisioneve, ndër të cilat është edhe Komisioni për çështje evropiane dhe Komisioni për politikë të jashtme, si dy komisione mjaft të rëndësishme në përpjekjet e Maqedonisë për afrim kah UE dhe Aleanca e NATO-s; janë shefe të më shumë delegacioneve në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, ndër të tjera janë edhe të delegacioneve në Kuvendin Parlamentar të NATO-s, Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës.

Në të njëjtën kohë zonja Karolina Ristova informoi se janë bërë ndryshime edhe në Ligjin për zgjedhjet lokale. Me vendosjen e kuotës së 30% nga të dyja gjinitë ndërmjet kandidatëve të listave për këshillat lokale, nënvizoi se priten ndryshime të dukshme edhe në përfaqësimin e grave në vetadministrimin lokal.

Në fund të diskutimit të saj zonja Ristova theksoi se Maqedonia ka bërë shumë në drejtim të zmadhimit të përfaqësimit dhe ndikimit të grave në politikë, por se edhe më tej angazhimi do të vazhdojë të zhvillohen në këtë drejtim.

Më 30 shtator, Komisioni i tretë i përhershëm me konsensus miratoi edhe Projekt-rezolutën e parashtruar nga referuesit, të ndryshuar me amendamentet e përkrahura. Në mbledhje, gjithashtu, u përcaktuar temat për debat të Komisionit të tretë për Kuvendin 112 dhe 113 të KUI. Anëtarët e Komisionit vendosën që Kuvendit t'i propozojnë temat në vijim për kyçje në rendin e ditës së kuvendeve vijuese:

- për Kuvendin e 112: "Roli i parlamenteve në promovimin dhe implementimin e respektimit të të drejtave të njeriut në strategjinë për

- parandalimin, administrimin dhe shërimin e pandemisë së HIV/SIDA", dhe
- për Kuvendin e 113: "Rëndësia e shoqërisë qytetare dhe lidhshmëria e saj me parlamentet dhe kuvendet tjera të zgjedhura në mënyrë demokratike në pjekurinë dhe zhvillimin e demokracisë, me qëllim të përmirësimit të kushteve për jetë".

MIRATIMI I REZOLUTAVE NË KUVENDIN e 111 TË UIP-së

Në mbledhjen plenare të mbajtur më 1 tetor 2004 Kuvendi debatoi dhe i miratoi raportet e komisioneve të përhershme dhe rezolutat e propozuara për pikat e rendit të ditës.

Propozim-rezoluta për pikën e tretë të rendit të ditës u miratua me konsensus, me rezervë nga delegacionet e Izraelit dhe të Indisë. Për rezolutën e pikës së pestë të rendit të ditës, e cila gjithashtu u miratua me konsensus, rezervë për nëntitull "siguri njerëzore" shfaqti Delegacioni i Indisë. Njëzëri u miratuan edhe rezolutat për pikën e katërt dhe të tetë (plotësim urgjent) të rendit të ditës.

Në mbledhjen e Kuvendit u miratuan temat e propozuara për diskutim në suaza të komisioneve të përhershme për Kuvendin e 112 dhe të 113 të Unionit Interparlamentar, kurse si temë për diskutim në debatin e përgjithshëm për gjendjen politike, ekonomike dhe sociale në botë të Kuvendit të 112 të KUI që do të mbahet prej 3 deri më 8 prill 2005 në Manilë, Filipine u miratua: "Ndikimi i politikave nacionale dhe ndërkombëtare mbi gjendjen e gruas".

NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E STATUTIT TË UNIONIT

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës, Kuvendi i shqyrtoi ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Statutit dhe Rregullave të Unionit.

Rregullat e Kuvendit dhe Rregullat e komisioneve të përhershme u plotësuan në pjesën që ka të bëjë me afatin e parashtrimit të amendamenteve për rezolutat e propozuara nga referuesit e komisioneve. Me dispozitat e miratuara u mundësua që mbledhja e grave parlamentare të parashtrijë amendamente që kanë të bëjnë me perspektivën gjinore deri në mbylljen e mbledhjes së parë të Komisionit të përhershëm përkatës.

U miratuan edhe amendamente për Rregullat e komisioneve të përhershme që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e referuesve në komisionet teknike si dhe amendamente të Normativave financiare që kanë të bëjnë me fondet e Unionit dhe të furnizimeve.

MBLEDHJA E 175 E KËSHILLIT DREJTUES TË UIP

Mbledhja e Këshillit drejtues të UIP u mbajt më 28 shtator dhe 1 tetor 2004, nën kryesinë e kryetarit të KUI z. Serxho Paez Verdugo.

Në punën e Këshillit mori pjesë zonja Angellka Peeva Luarençiq, z. Çedomir Krlevski dhe z. Ismet Ramadani anëtar i Këshillit drejtues.

Kryetari i KUI paraqiti raporte gojore për aktivitetet e kryetarit ndërmjet dy mbledhjeve të Këshillit dhe për mbledhjen e 234 të Komitetit ekzekutiv. Këshilli konstatoi se sekretari i përgjithshëm parashtroi raport vjetor për aktivitetet e Unionit në vitin 2003.

Pjesëmarrja në Union

Këshilli, me rekomandimin e Komitetit ekzekutiv, i miratoi kërkesat për marrjen e statusit të anëtarit shoqëruar të Unionit të Parlamentit të Bashkësisë Ekonomike të Shteteve të Afrikës Perëndimore (ECOWAS) dhe të Kuvendit ligjvënës të Afrikës Lindore.

Këshilli drejtues, gjithashtu, miratoi raportin e Komitetit ekzekutiv për strukturën dhe funksionimin e anëtarëve të KUI dhe pjesëmarrjen e tyre në punën e organizatës.

Gjendja financiare e Unionit dhe buxheti për vitin 2005

Në mbledhje u shpërnda raporti me shkrim për gjendjen financiare të Unionit Interparlamentar përfundimisht me 30 qershor 2004, me listën e anëtarëve që i kanë ngelur borxh Unionit.

Informuesi i Komitetit Ekzekutiv z. Xhon Ostin, parashtroi raport për propozim-programin dhe buxhetin për vitin 2005. Komiteti ekzekutiv propozoi rritjen e mjeteve financiare për Konferencën e dytë botërore të spikerëve të parlamenteve që do të mbahet në Nju-Jork, për Konferencën e katërt dhe të fundit për siguri dhe bashkëpunim të Mesdheut (CSCM) që do të mbahet në Athinë dhe për Kuvendin e 112 të KUI që do të mbahet në Manilë. Këshilli drejtues miratoi propozim-buxhetin për vitin 2005 me amendamentet e propozuara dhe caktoi z. Ramon Verier, deputet nga Kuba dhe z. Surand Vejaxhiva, deputet nga Tajlanda për revizorë të brendshëm të Unionit për vitin 2004.

Bashkëpunimi me sistemin e Kombeve të Bashkuara

Këshilli përkrahur raportin për bashkëpunim me sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe u informua me iniciativat e ngritura për formimin e strukturave interparlamentare të OKB-së, me ç'rast u theksua nevoja për definimin dhe precizimin e këtij bashkëpunimi.

Këshilli drejtues miratoi rezolutën që do të parashtrohet për miratim në Kuvendin e Përgjithshëm të KB, nën pikën për bashkëpunim ndërmjet OKB dhe KUI. U nënvizua se me rëndësi të jashtëzakonshme është që rezoluta e propozuar të miratohet pa ndryshime, me qëllim që Konferenca botërore e spikerëve të parlamenteve të definohet si mbledhje e përbashkët e KB dhe KUI, me çka do t'u iket vështirësive rreth dhënies së vizave amerikane për të gjithë pjesëmarrësit e konferencës.

Këshilli, gjithashtu, miratoi propozimet për formimin e komisioneve të specializuara për HIV/SIDA dhe për mbrojtjen e fëmijës të përpilura në bashkëpunim me UNAIDS dhe UNICEF.

Konferencat dhe mbledhjet e specializuara

Anëtarët e Këshillit drejtues u informua me rezultatet nga Mbledhja e spikerëve të parlamenteve të shteteve fqinje të Irakut për procesin kushtetues

në Irak të mbajtur më 12 dhe 13 maj 2004 në Aman, Jordani. Deklarata e përbashkët e miratuar në mbledhje, me kërkesë të Qeverisë së Jordanisë, u shpërnda si dokument oficial i Kuvendit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Sigurimit të KB dhe iu dërgua sekretarit të përgjithshëm i KB dhe Qeverisë së përkohshme të Irakut.

Këshilli, gjithashtu u informua me epilogun e Mbledhjes parlamentare të mbajtur në kornizë të UNCTAD XI, Seminarin e regjionit arab për parlamentin dhe për procesin buxhetor dhe Konferencën parlamentare për refugjatë në Afrikë: sfida për mbrojtje dhe zgjidhje.

Raportet për punën e komisioneve dhe trupave të tjerë të Unionit

Në Këshillin drejtues u prezantuan raportet për aktivitetet e Komitetit koordinues të grave-anëtare të parlamenteve, Komitetit për të drejtat e njeriut të parlamentarëve, Komiteti koordinues të Konferencës për bashkëpunim dhe siguri të Mesdheut dhe Grupit për partneritet ndërmjet gjinive.

Mbledhjet e ardhme interparlamentare

Këshilli u njoftua me kalendarin tani më të caktuar të aktiviteteve të ardhme të Unionit, me çka lejoi mbajtjen e mbledhjeve në vijim: Konferencës së katërt për bashkëpunim dhe siguri të Mesdheut (Athinë, shkurt 2005); Seminarit për parlamentet, menaxhimin për mjedisin jetësor dhe zhvillimin e përhershëm (Paris, në fillim të vitit 2005); Konferencës regjionale afrikane për mutilacion gjenital për gratë (shkurt 2005), Seminarit për parlamentet latine-amerikane për parlamentin dhe procedurën buxhetore (mars 2005); Mbledhjes parlamentare në suaza të sesionit 49 të Komisionit për statusin e grave; Pekin + 10 (selia e KB në Nju-Jork mars 2005) dhe Mbledhjes së tretë e Komitetit përgatitor për Konferencën e dytë të spikerëve të parlamenteve (Librevill, 19-21 maj 2005).

Këshilli drejtues vendosi që të sponsorojë mbledhjen tematike për rolin e parlamenteve në implementimin e Konventës për ndalimin e armatimit kimik që e organizon Organizata për ndalimin e armëve kimike (OPCW) më 26 nëntor 2004 në Hagë.

PJESËMARRJA NË PUNËN E TRUPAVE, FORMAT DHE AKTIVITETET E TJERA TË UNIONIT

TAKIMI I KOMITETIN KOORDINUES TË KONFERENCËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM TË MESDHEUT (CSCM)

Anëtarët e Komitetit koordinues të Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim të Mesdheut (CSCM) e mbajti takimin e vet të 30-të në Gjenevë, të martën, më 28 shtator 2004. Me mbledhjen kryesoi z. Rudi Sal, deputet nga Franca dhe nënkryetar i Komitetit ekzekutiv të KUI. Sipas marrëveshjes në mbledhjen e 22-të të përfaqësuesve të pjesëmarrësve në procesin CSCM, të mbajtur në Meksiko Siti në prill të vitit 2004, mbledhja ishte e hapur për të gjithë anëtarët me të drejta të plota dhe anëtare asociative që duan të marrin pjesë.

Në mbledhje morën pjesë:

- përfaqësues nga dhjetë prej gjithsej 11 shteteve anëtare të Komitetit koordinues: Algjeria, Egjipti, Franca, Italia, Malta, Maroko, Spanja, Sllovenia, Tunizia dhe përfaqësuesi i Grupit punues të grave mediterane zonja Andrulla Vasilui nga Qiproja.
- përfaqësues nga nëntë prej 14 pjesëmarrësve të tjerë: Qiproja, Greqia, Izraeli, Jordania, Libani, Monako, Portugalia, Maqedonia dhe Turqia, si dhe
- përfaqësues të pjesëmarrësve asociativë: Britania e Madhe, Palestina, Kuvendi i BUE, Parlamenti Evropian dhe Unioni Interparlamentar arab.

Në mbledhje u shqyrtua ftesa e pranuar nga Kuvendi Parlamentar Euromesdhetar që KUI për Kuvendin vijues të paraqesë kërkesë për marrjen e statusit të vëzhguesit.

Vëmendje e veçantë në diskutim, në të cilin mori pjesë edhe deputeti z. Çedomir Krlevski, iu kushtua propozimit për formimin e Kuvendit Parlamentar të Mediteranit dhe u shqyrtua edhe Projekt-statuti të Kuvendit. Pas debatit të gjatë në të cilin u përkrahën edhe më shumë amendamente, u miratua statuti i ndryshuar.

Në mbledhjen e fundit në Meksiko Siti përfaqësuesit e pjesëmarrësve në procesin e CSCM u pajtuan që Konferenca e katërt për siguri dhe bashkëpunim e Mesdheut (CSCM) të mbahet në fillim të viti 2005, për çka Greqia dhe Monako bënë ftesë për nikoqir të mbajtjes së tij. Në mbledhjen në Gjenevë përfaqësuesit u pajtuan që Greqia të jetë nikoqire e Konferencës së katërt për siguri dhe bashkëpunim të Mesdheut, ku pritet të miratohet edhe Projekt-statuti dhe CSCM të transformohet në Kuvend Parlamentar të Mesdheut, për çka ekziston pajtueshmëri nga gjithë përfaqësuesit.

GRUPI GEOPOLITIK "DYMBËDHJETË PLUS"

Grupi "Dymbëdhjetë plus" mbante takime të rregullta para mbledhjeve të trupave të Unionit më 27 shtator, si dhe prej 29 shtator deri 1 tetor 2004. Nga Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Interparlamentar në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit drejtues zonja Angellka Peeva Luarençiq, z. Çedomir Krlevski dhe z. Ismet Ramadani.

Kujdes i veçantë gjatë rrjedhës së mbledhjes iu kushtua kërkesës së Parlamentit Evropian për anëtarësim me të drejtë të barabartë në Unionin Interparlamentar 7). Kjo kërkesë nuk është në pajtim me nenin 3 të Statutit të Unionit që parashihet se anëtarë me të drejta të barabarta të KUI mund të jenë vetëm parlamentet e shteteve sovraane.

Duke marrë parasysh se PE nuk mund të fitojë statusin e anëtarit me të drejta të barabarta të Unionit Interparlamentar pa ndryshimin e Statutit të KUI, para anëtarëve të Grupit "Dymbëdhjetë plus" prezantua Propozim-amendamenti me të cilin parashihet plotësim i nenit 3. Me ndryshimet e propozuara u parashikua anëtarësimi në Union edhe i kuvendeve parlamentare ndërkombëtare që kanë fuqi ligjore dhe kryejnë mbikëqyrje të pushtetit ekzekutiv, kurse anë formuar në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, nga shtete anëtare të Unionit. Ky propozim nuk e fitoi shumën e duhur të dy të tretave nga anëtarët e Grupit. 8).

Në mbledhjet e grupit gjeopolitik "Dymbëdhjetë plus" u harmonizuan qëndrimet për pikën plotësuese të rendit të ditës së Kuvendit dhe iu dha përkrahje kandidatëve nga anëtarët e Grupit për funksionet e zbratura në organet dhe trupat KUI dhe për komisionet teknike, kurse u shqyrtuan edhe çështjet e tjera nga kompetenca e Grupit gjeopolitik dhe të Unionit Interparlamentar.

DISKUTIMI PANEL PËR SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHET E DREJTA HUMANITARE NDËRKOMBËTARE

Diskutimi panel për sfidat me të cilat ballafaqohet e drejta humanitare ndërkombëtare u mbajt më 28 shtator 2004. Panelin e karakterizuan katër spikerë që kishin fjalë hyrëse, çdonjëri prej tyre duke prezantuar tema të ndryshme nga sfera, para se të hapet debati për temën. Zoti Jakob Kelenberger, kryetar i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), foli për sfidat me të cilat ballafaqohet e drejta humanitare ndërkombëtare dhe zbatimi i saj, para se të vështrojë çështjen për sigurinë e personelit humanitar në terren. Zonja Elizabet Villmshurst, udhëheqëse e programit për të drejtën humanitare të Institutit Mbretëror për Punë Ndërkombëtare nga Londra, u ndal në sfidat gjatë zbatimit të së drejtës humanitare ndërkombëtare, potencuar nevojën që parlamentet të bëjnë presion mbi qeveritë e tyre, me qëllim që të ratifikojnë Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Zoti Marko Sasoli, profesor i së drejtës ndërkombëtare të Universitetit në Gjenevë, theksoi problemet e ndryshme me të cilat ballafaqohet e drejta humanitare ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.

Dr. Vinset Biruta, kryetar i Senatit të Ruandës, foli nga perspektiva e tij nacionale, përkatësisht për masat të cilat i ndërmori vendi i tij, me qëllim që të realizohet e drejta mbi gjenocidin në vitin 1994.

Në panel diskutimin mori pjesë edhe deputetja Karolina Ristova. Ajo diskutoi shkurt për sfidat e realizimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare, në bazë të eksperiencave të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht në raste të konfliktit të brendshëm (qytetar) kur konflikti përfundon me marrëveshje paqësore, amnisti dhe kyçe të aktorëve joshtetërorë në konflikt në institucionet shtetërore. Në këto raste, shteti doemos duhet të balancojë ndërmjet paqes dhe ndjekjes së kryerësve potencialë të shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare.

Po ashtu, ajo vuri në dukje se problem i ngjashëm ekziston në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë dhe se kjo nuk është sfidë vetëm për shtetin, por edhe për Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, e cila shpesh akuzohet për qasje selektive dhe "akuza politike", përkatësisht mosndjekje të të akuzuarve potencialë nëse kjo e keqëson gjendjen politike, madje edhe paqen dhe sigurinë e shtetit. Në këtë kuptim, ajo u parashtroi pyetje panelistëve për mendimin edhe komentin e tyre për këtë sfidë me të cilën po ballafaqohet e drejta ndërkombëtare për çka iu dha përgjigje se bëhet fjalë për çështje veçanërisht delikate, për shkak të faktit që vështirë është të gjykosh dikë që ka qenë faktor në vendosjen e paqes.

MBLEDHJA E SHOQATËS SË SEKRETAËVE TË PËRGJITHSHËM TË PARLAMENTEVE

Gjatë rrjedhës së Kuvendit u mbajt mbledhja e Shoqatës së sekretarëve të përgjithshëm të parlamenteve (SHSPP), në të cilën mori pjesë zonja Roksa Georgievska, zëvendëssekretare e përgjithshme e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Në Mbledhjen u mbajtën debate të përgjithshme në dy tema: "Kontrolli financiar i parlamentit" dhe "Dëshira që sa më shpejt të votohen propozim-ligjet dhe nevoja e sigurimit të shqyrtimit adekuat të tyre: dy kërkesa kontradiktore". Moderatorin e debatit për temën e parë ishte z. Hafnaoui Amrani, sekretar i përgjithshëm i Këshillit Nacional të Algjerisë, ndërsa me debatin për temën e dytë udhëhoqi z. Roxher Sends, sekretar i përgjithshëm i Dhomës së Poshtme të Mbretërisë së Bashkuar.

Në suaza të debatit të parë kontributin e vet për kontrollin financiar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dha zonja Roksa Georgievska, zëvendës-sekretare e përgjithshme e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. I bëri vështrim kontrollit financiar mbi shpenzimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit dhe trupave më lartë financiar.

Në mbledhjen e Shoqatës së sekretarëve të përgjithshëm të parlamenteve u parashtruan edhe këto ekspozë: "Autonomia financiare e Kuvendit Nacional të Angolës në suaza të sistemit buxhetor të shtetit", "Komisionet për ardhmërinë e Parlamentit të Finlandës", "Komisione të

angazhuara për ministrin e resorit: eksperiencia e Indisë" dhe "Garantimi i etikës së sjelljes në Parlamentin e Indisë".

Sekretari i përgjithshëm i Senatit të Filipineve z. Oskar Jabes, informoi për përgatitjet e mbajtjes së mbledhjes së ardhshme të SHSPP që do të mbahet në Manila, në suaza të Kuvendit 112 të Unionit Ndërpametar.

Shoqata zgjodhi edhe anëtar të rinj të Komitetit ekzekutiv të SHSPP.

AKTIVITETE TË TJERA GJATË MBAJTJES SË KUVENDIT

Më 30 shtator 2004 u mbajt debati për pandeminë HIV/SIDA dhe aktivitetet e parlamenteve dhe anëtarëve të tyre në lidhje me këtë problem. Parlamentarëve iu drejtua dhe iu përgjigj pyetjeve drejtori ekzekutiv i UNAIDS dr. Peter Piot. Debatin e organizoi grupi "Dymbëdhjetë plus" me rastin e tridhjetëvjetorit të këtij grupi gjeopolitik.

Gjatë Kuvendit u mbajtën mbledhje të Komitetit ekzekutiv, Komitetit koordinues të grave parlamentare, Komisioni6t për të drejtat e njeriut të parlamentarëve, Grupit për partneritet ndërmjet gjinive dhe Këshillit të fondacionit interparlamentar për demokraci.

Gjatë kohës së Kuvendit të111 të UIP, Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë realizoi takim me Delegacionin e Serbisë dhe Malit të Zi, të udhëhequr nga z. Milorad Dërleviq, nënkryetar i Kuvendit të Serbisë dhe Malit të Zi, me kërkesë të tij. Në takim u shkëmbyen mendime në lidhje me gjendjen aktuale në Serbi dhe Malin e Zi, Republikën e Maqedonisë dhe në rajon dhe theksua nevoja për intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve si në planin bilateral ashtu edhe në planin multilateral.

SHQYRËTIMET PËRFUNDIMTARE

Mund të vlerësohet se pjesëmarrja e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në Kuvendin 111 të UIP ishte shumë i suksesshëm, aktiv dhe konstruktiv. Me pjesëmarrjen e deputetëve u mundësua prezantimi i qëndrimeve të deputetëve maqedonas për çështjet aktuale nga domeni i kompetencave të UIP.

Krahas kësaj, u realizua pjesëmarrje aktive në punën e strukturave organizative të Unionit, si dhe kontakt paraprak dhe takime me parlamentarët nga shumë shtete. Me këtë ka vazhduar kontinuiteti i bashkëpunimit edhe në ndërtimin e qëndrimeve të UIP, dhe veçanërisht në pikëpamje të afirmimit të Republikës së Maqedonisë në plan më të gjerë ndërkombëtar.

REZOLUTA TË MIRATUARA

SITUATA ALARMANTE NË IRAK DHE NEVOJA PËR AKTIVITET PARLAMENTAR QË DO TË KONTRIBUOJË PËR KTHIMIN E PAQES DHE SIGURISË NË VEND

Rezoluta e miratuar njëzëri nga Kuvendi 111 i UIP (Gjenevë, 1 tetor 2004)

Kuvendi 111 i Unionit Interparlamentar,
Të brengosur seriozisht për gjendjen e keqësuar në Irak, duke shprehur
keqardhje e thellë për të gjitha viktimat, veçanërisht mes popullatës civile.

Edhe një herë duke e vërtetuar të drejtën e popullatës irakiane
ose të njerëzve irakian ta përcaktojnë ardhmërinë e tyre dhe t'i
kontrollojnë resurset e tyre natyrore,

Duke e vërtetuar përmbajtjen e tyre për parimet e mbajtjes së
sovrانيتit, integritetit territorial dhe sigurisë së Irakut,

Duke u përkujtuar në institucionet relevante të Unionit
Interparlamentar (UIP) veçanërisht në rezolutën e miratuar të 108.
Kuvendi Interparlamentar (Santiago de Çile, 2003) dhe deklarata në
Mbledhjen e folësve të parlamenteve të vendeve fqinje të Irakut (Aman,
2004),

Duke u përkujtuar në rezolutat relevante të Kombeve të
Bashkuara, veçanërisht në rezolutat 1546 (2004) dhe 1557 (2004) të
Këshillit për Siguri të Kombeve të Bashkuara,

Të vetëdijshëm për rolin të cilin UIP doemos duhet ta ketë në
Irak në promovimin e paqes, demokracisë dhe bashkëpunimit, përmes
ndihmës me dialog dhe konsolidim të institucioneve përfaqësuese,

Duke vërejtur se ka konsensus për mbajtjen e konferencës
ndërkombëtare e cila do t'u mundësojë njerëzve irakian që të kyçen në
procesin e normalizimit dhe demokracisë dhe për ndihmë në mbajtjen
e zgjedhjeve të lira,

1. Edhe një herë e vërteton vlerën fundamentale të
multilateralizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në
zgjidhjen e konflikteve ndërmjet shteteve dhe se Kombet
e Bashkuara janë organizata e vetme, e autorizuar me
Kartën të shfrytëzojë forcë;
2. E gjykon vrasjen e irakianëve të pafajshëm dhe shtetasve
tjerë dhe kidnapimin e përhershëm, duke përfshirë edhe
punëtorët humanitarë;
3. Shpreh brengosje të thellë për dëmin e shkaktuar në
vendet religjioze dhe kulturore në vend;
4. Edhe një herë vërteton se Kombet e Bashkuara duhet të
ndërmarrin rolin udhëheqës në procesin politik në Irak,
duke e përfshirë procesin e rekonstruktimit dhe thekson
se pasuria e Irakut nuk duhet të shfrytëzohet, as të

varfërohen resurset nacionale për realizimin e procesit të rekonstruktimit;

5. Kërkon mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe ferr për kthimin e demokracisë dhe sundimit të së drejtës si dhe vendosjen e Parlamentit të ri dhe legjitim në Irak;
6. Edhe një herë vërteton se populli i Irakut doemos duhet ta mbajë pronësinë mbi të gjitha resurset e tyre natyrore dhe kulturore dhe i thërret Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të saja dhe bashkësia ndërkombëtare në tërësi të punojnë bashkë me Qeverinë e përkohshme të Irakut që të sigurojnë trashëgimia kulturore e Irakut të kthehet në këtë vend.
7. Fuqimisht i fton të gjitha palët të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat religjioze, etnike dhe kulturore, e gjithashtu kërkon pjesëmarrjen e plotë dhe të njëjtë të të gjithë irakianëve në ndërtimin e Irakut, me theks të veçantë për pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha fazat e rekonstruktimit dhe vendosjes së institucioneve të reja politike në vend;
8. Kërkon pjesëmarrje më të madhe nga të gjitha shtetet në përpjekjet e tanishme për ndihmë të popullit të Irakut në rekonstruktimin dhe zhvillimin e ekonomisë së Irakut, duke përfshirë sigurimin e ekspertëve ndërkombëtar dhe resurset e nevojshme dhe me program të koordinuar të ndihmës së donatorëve;
9. I thërret të gjitha palët që të sigurojnë se gratë do të jenë plotësisht të integruara në të gjitha nivelet e negociatave për marrëveshje paqësore dhe se programet rezultuese për rekonstruktim do të kyçin perspektivë gjinore, e cila i reflekton nevojat speciale dhe investimet e grave;
10. E nënvizon rolin fundamental që duhet ta luajnë shtetet fqinje që të sjellin ndryshime pozitive në gjendjen momentale në Irak, përmes përforsimit të sigurisë regjionale, në të vërtetë përmes zvogëlimit të tensioneve dhe sigurimit të ndihmës humanitare dhe ndihmës për rekonstruktim, për lehtësimin dhe përfundimin e vuajtjeve të popullit irakian, kurse të gjithë ato janë drejtpërdrejtë të lidhur me sigurinë në regjion;
11. Kërkon implementimin e rekomandimeve të përmbajtura në Deklaratën e Mbledhjes së folësve të parlamenteve nga shtetet fqinje të Irakut, të mbajtur në UIP, në Aman më 12 dhe 13 maj 2004;
12. I inkurajon Kombet e Bashkuara që ta shfrytëzojnë ekspertizën e ofruar të UIP gjatë mbajtjes së konferencave ndërkombëtare të cilat do të japin kontribut për vendosjen e Irakut demokratik;
13. Propozon që Kombet e Bashkuara dhe institucionet irakiane të vendosin partneritet me UIP, me qëllim të mundësohet UIP:

(I) të ndihmojë në vendosjen dhe konsolidimin e institucioneve parlamentare;

(II) ta përmbajë Parlamentin e ri të Irakut gjatë diskutimit të projektin e kushtetutës,

(III) të punojë së bashku me to për të mirën e demokracisë dhe stabilitetit regjional;

14. Vendosë prej së afërmi ta përcjellë zhvillimin e ngjarjeve që të sigurojë

implementim urgjent të rekomandimeve të lartpërmendura dhe i fton

kryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm që të parashtrojnë raport për atë në

Sesionin 112 të tij.

**ROLI I PARLAMENTEVE NË FORCIMIN E REGJIMEVE MULTILATERALE
PËR MOSZGJERIMIN E ARMËVE DHE PËR ÇARMATIM, NË DRITËN E
SFIDAVE TË REJA TË SIGURUARA**

**Rezolutë e miratuar njëzëri nga Kuvendi 111-të i UIP
(Gjenevë, 1 tetor 2004)**

Kuvendi i 111-të i Unionit Interparlamentar,

Duke i pranuar rreziqet për paqen, stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare nga hovi i pakontrolluar dhe shpërndarja e armës, ndërsa veçanërisht ajo për shkatërrimin masiv dhe mjeteve të tyre të dërgesës,

Thellë të tronditur nga vuajtjet dhe shkatërrimin e njerëzimit nëpërmjet ndikimit fatal të armëve, luftërave dhe aktiviteteve terroriste,

Thellë të brengosur për efektet e deponimit të tanishëm të armëve mbi ekonominë botërore, klimën globale dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në botë,

Duke i thirrur të gjitha shtetet t'i përforcojnë përpjekjet rajonale në fushën e ndërtimit të masave për besim për arsye të promovimit të klimës së sigurisë dhe sigurimit, marrëdhënies të qeta dhe të mira fqinjësore,

Duke pasur parasysh Kartën e Kombeve të Bashkuara, e veçanërisht të neneve 2 dhe 26 për atë,

Të vetëdijshëm për Deklaratën universale për të drejtat e njeriut dhe të gjitha marrëveshjet, kontratat dhe instrumentet e tjera të lidhura me të drejtat e njeriut dhe respektimin e dinjitetit njerëzor,

Duke pranuar rolin primar dhe themelor të Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit ekonomik dhe social në promovimin e përparimit të grave dhe barazisë gjinore, ndërsa gjithashtu duke u thirrur në Rezolutën 1325 (2000) për gratë, paqen dhe sigurinë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

Duke përsëritur rëndësinë e rezolutave të miratuara nga UIP prej vitit 1994 për paqe, siguri dhe çarmatim veçanërisht në Konferencat 91, 93, 94, 96, 98, 101 dhe 108, të Kuvendit 109 dhe Seksionit special të Këshillit të UIP i mbajtur në 1995,

Të vetëdijshëm për rëndësinë për ndalimin e luftës kundër terrorizmit nga rrezikimi i rezultateve pozitive të arritura në fushën e obligimeve për çarmatimin dhe masat për ndërtim të besimit

* Delegacioni i Izraelit tha se nuk do që të kundërshtojë miratimin e Rezolutës, por do që të shënohet si rezervim serioz në pikëpamje të disa pjesëve dhe paragrafëve në tekst. Delegacioni i Indisë theksoi se përkrahja e saj e Rezolutës nuk e prejudikon qëndrimin e saj në pikëpamje të konventave, marrëveshjeve ose regjimeve në të cilat nuk ka qenë palë.

Të alarmuar nga qasja e gjerë te sasi të mëdha të armëve, nga armët e lehta deri te të gjitha llojet e minahedhësve dhe minave kundër këmbësorisë, ndërsa të gjitha paraqesin kërcënim për sigurinë njerëzore si dhe sistemet bartëse kundërajrore (MANPADS) të cilat paraqesin kërcënim të rritur për aviacionin civil, duke e vërtetuar rëndësinë të kontrollimit adekuat të armatimit të lehtë dhe duke u drejtuar në nevojën për prishjen e transaksioneve ilegale me armatim të lehtë nëpërmjet grupeve të organizuara kriminale ndërkombëtare dhe organizatave terroriste dhe aktiviteteve kriminale të cilat financojnë grupe dhe organizata të këtitilla,

Duke theksuar rëndësinë e Regjistrimit për armë konvencional të Kombeve të Bashkuara në promovimin e hapjes dhe transparencës së fushës së armatimit dhe duke e përkrahur përfundimin e mëtejshëm të operacioneve dhe vëllimeve të tij,

Duke shprehur kënaqësinë për beneficionet e marrëveshjeve të lidhura për kontrollimin e armatimit, siç janë Marrëveshja strategjike për zvogëlimin e armëve (START), Marrëveshja për zvogëlimin e mjeteve strategjike ofensive (SORT) dhe Marrëveshja për forcat e armatosura konvencionale në Evropë (CFE marrëveshja), Marrëveshja për mos zgjerimin e armës bërthamore (NPT), Konventa për armatim kimikë (CWC) dhe Konventa për ndalimin e zhvillimit, prodhimit dhe deponimit të armëve bakteriolgjike (biologjike) dhe toksike dhe për shkatërrimin e tyre (BTWC) dhe duke shpresuar se ato mund të jenë paraardhës të zvogëlimit të mëtejshëm të armëve dhe marrëveshjeve për çarmatim,

Duke përkujtuar rëndësinë nga dhe nevoja për respektimin e së drejtës ndërkombëtare në kohën e konfliktit të armatosur,

Duke pranuar përparimin me NPT dhe Marrëveshjet me rezultate për mbrojtje si CWC dhe BTEC dhe duke i ftuar fuqitë bërthamore dhe shtetet tjera të marrëveshjes t'i bëjnë efektive angazhimet të cilat i kanë ndërmarrë gjatë kontrollit NPT dhe konferencat për zgjerim të mbajtura nga Kombet e Bashkuara në vitin 1995 dhe 2000, si dhe rekomandimet për të,

Duke pranuar rolin kyç të marrëveshjeve multilaterale jo diskriminuese për çarmatim, si CWC dhe BTWC dhe duke e theksuar nevojën rrjedhëse për përkrahjen dhe përfundimin e NPT, njëkohësisht duke shprehur brengosje për atë se shteti ka vendosë të tërhiqet nga ajo Marrëveshje,

Të bindur se Marrëveshja për ndalim të plotë të testimeve bërthamore (CTBT) luajnë rol qendror në çarmatimin ndërkombëtar bërthamor dhe mbajtjen e kornizës për mos zgjerimin e tij e bazuar në NPT dhe se zbatimi i CTBT është mënyra efektive dhe konkrete që të eliminohet arma bërthamore.

Duke anticipuar përfundimin e hershëm të Marrëveshjes për ndërprerje të materialit fisik (FMCT) për ngrirjen e kapaciteteve të prodhimitarisë

bërthamore në shtetet për armë bërthamore dhe ato shtete të cilat nuk janë pjesë e NPT,

Të vetëdijshëm për besimin e ndërsjellë të krijuar me zonat e lira rajonale për armë bërthamore si ato në Pacifikun e Jugut, Afrikë, Azinë Juglindore dhe Amerikën Latine,

Duke vlerësuar Marrëveshjet e lidhura për demilitarizim të Antarktikut dhe fundit të detit si mënyrë për mbrojtjen e sferave të dijshme të ekosistemit të planetit,

Të vendosur të luajnë rol pozitiv në pengimin e qasjes të armët nga ana e organizatave terroriste, terroristët, kriminelët ndërkombëtar dhe qeveri me ambicie ofensive,

Të vetëdijshëm për arritjet në fushën e mos zgjerimit, kontrollit të armëve dhe çarmatimit nuk duhet të merren si çështje e kryer,

Të brengosur se implementimi i plot i marrëveshjeve të caktuara për zvogëlimin e armëve, çarmatimin dhe mos zgjerimin është lëndë në pritje dhe interpretime të ngadalësuara, të cilat e zvogëlojnë efikasitetin,

Të bindur se qasja multilaterale drejt çarmatimit dhe mos zgjerimit janë hap më i mirë përpara, sepse i njëjti siguron besim afatgjatë dhe stabilitet më të madh rajonal dhe ndërkombëtar,

Duke besuar se regjimet me bisedimet multilaterale, jo diskriminuese, të verifikuara për përkufizimin e transferimit të teknologjive kyçe në sferën e armës kimike, biologjike dhe bërthamore dhe në fushën e projektileve kontribuojnë për parandalimin e zgjerimit të armëve për shkatërrim masiv dhe mjetet e tyre për dorëzim,

Duke u përpjekur për kontroll me përgjegjësi të tregtisë me mallra, pajisje dhe teknologji, duke përfshirë përdorim të dyfishtë të materialeve të cilat mund të shfrytëzohen për armë për shkatërrim masiv dhe mjetet e tyre për dorëzimin dhe duke i pranuar të drejtat dhe përgjegjësit e shteteve për përdorimin e tyre për energji bërthamore, agjenset kimike dhe biologjike dhe toksine për qëllime të qeta,

Duke u obliguar të realizojnë inkuadrim parlamentar në procesin e çarmatimit, përkatësisht në marrëdhënie të armës bërthamore, kimike dhe biologjike për shkatërrim masiv, duke bërë shtypje në qeveritë dhe duke siguruar kontroll detal të buxheteve ushtarake dhe programeve për furnizim,

Me dëshirë që t'u ndihmojnë trupave ndërkombëtar parlamentar, veçanërisht Unionit Interparlamentar (UIP) të punojnë aktivisht në promovimin e procesit të kontrollit, çarmatimit dhe armatimit,

Duke theksuar se qeveritë i këmbëjnë të gjitha informatat relevante në mënyrë të tërësishme me parlamentarët në bazë të besimit të ndërsjellë,

1. I fton parlamentet të sigurojnë fuqi dhe përmbajtje efektive për të gjitha rezolutat dhe rekomandimet për paqe, çarmatim dhe sigurim më parë të miratuara në konferencat dhe kuvendet e UIP;
2. Kërkon nga parlamentet nacionale t'u bëjnë shtypje qeverive të tyre t'i nënshkruajnë, qasen dhe ratifikojnë të gjitha konventat, marrëveshjet dhe instrumentet të tjera ndërkombëtare të cilat janë të dedikuara të sigurojnë mos shpërndarjen, kontrollin e armëve, çarmatimin dhe sigurinë më të madhe ndërkombëtare dhe për implementimin e tyre të plotë;
3. I fton qeveritë, parlamentet nacionale dhe bashkësinë ndërkombëtare të shqyrtojnë shkaqet rrënjësore të cilat formojnë rreth që mund t'i nxitë njerëzit t'i ikin dhunës në nivel nacional ndërkombëtar dhe individual.
4. Kërkon thirrjen, nën përkrahjen e Kombeve të Bashkuara, të Konferencës ndërkombëtare për luftë kundër terrorizmit, ndër të tjera në pikëpamje të vendosjes së definicionit të qartë për këtë problem serioz;
5. I fton të gjitha vendet t'i mbindërtojnë të arriturat ekzistuese në çarmatimin, kontrollin e armëve dhe mos zgjerimin, që të sigurojnë se të gjithë janë procese të qëndrueshme në ardhmëri;
6. I fton Kombet e Bashkuara të punojnë së afërmi me UIP për zvogëlimin e tensioneve, zgjidhjen e konflikteve dhe luftën kundër terrorizmit;
7. Kërkon nga parlamentet të fokusohen, gjithashtu në sfera të caktuara ku ka tensione ndërkombëtare;
8. Më tutje kërkon identifikim të qartë të kërcënimeve më të rrezikshme për rendin dhe stabilitetin ndërkombëtar, si konflikti arab-izraelit dhe konfliktet në Irak dhe Afganistan, situata në rajonin e Darfurit dhe rajonin e Liqeneve të Mëdha në Afrikë dhe vendeve të tjera problematike që mund të paraqesin kërcënim serioz dhe të cilat kërkojnë aksion urgjent politikë për parandalimin e konfliktit;
9. Fton në përpjekje të qëndrueshme më aktive për rikonstruktimin e pas luftës që duhet të ndërmerret nga ana e Kombeve të Bashkuara që të parandalohen shpërthime të reja të paligjshmërisë, konfliktit, dhe terrorizmit të armatosur me fokus të kontinuar për udhëheqje të mirë dhe qeverisje të së drejtës;
10. I fton qeveritë dhe organizatat e ndërsjella t'i përkrahin përpjekjet për arritje të ndërprerjes urgjente të të gjitha formave të okupacionit si dhe për pranimin formal të përgjegjësisë nga ana e të gjitha forcave okupatore, t'i korrigjojnë të gjitha krimet e bëra me okupacionin dhe të veprojnë sipas së drejtës ndërkombëtare;

11. I inkurajon sekretariatet e UIP dhe të Kombeve të Bashkuara ta nxisin këmbimin e informatave, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të dy institucioneve dhe ndërmjet anëtarëve të tyre;
12. I fton të gjitha shtetet të përmbahen nga përdorimi unilateral i fuqisë në mungesë së rezolutës relevante nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
13. I fton parlamentet që më afër ta përcjellin implementimin nacional të të gjitha marrëveshjeve dhe rezolutave të Kombeve të Bashkuara për kontroll të armëve dhe mos zgjerimin e së njëjtës, të kyçen në shkëmbimin e informatave për praktika më të mira për monitorim të këtillë dhe ta informojnë Kuvendin e UIP për përparimin e bërë;
14. Më tej fton në pjesëmarrje më të gjerë nga ana e shteteve në Regjistrin për armë konvencionale të Kombeve të Bashkuara;
15. U rekomandon parlamenteve që për së afërmi ta përcjellin kompatibilitetin e vendimeve të degëve të tyre përkatëse ekzekutive për doktrinat strategjike, ndërtimin e forcave të armatës dhe hulumtimin, zhvillimin ose prodhimin e armëve, me Kartën e Kombeve të Bashkuara, normat dhe parimet e pranuar në mënyrë të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjet e vlefshme ndërkombëtare;
16. I inkurajon parlamentet të miratojnë legjislacionin përkatës nacional për kontrollimin e eksportit të armëve nga të gjitha llojet, veçanërisht duke u fokusuar në pikat e lidhura me armët për shkatërrim masiv, si komponentë dhe prekursorë;
17. Kërkon nga parlamentet dhe qeveritë e shteteve të cilat nuk e kanë nënshkruar CTBT që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për arritjen e fuqizimit të saj të shpejtë;
18. Insiston në nevojën për përforsimin e mëtutjeshme të BTWC, veçanërisht për vendosjen e mekanizmit të obliguar ligjor për verifikimin e saj;
19. I fton parlamentet dhe qeveritë evropiane, që pa prolongim ta ratifikojnë Marrëveshjen e adaptimit të Kontratës së CFE, duke marrë parasysh rëndësinë e saj të madhe për mbajtjen e shkallës së lartë të sigurisë dhe stabilitetit në Evropë.
20. Kërkon zhvillim të mëtejshëm të zonave ku nuk ka armë bërthamore, ndërsa veçanërisht implementimin e plotë të Rezolutës 687 (1991) të Këshillit të Siguri të Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet të cilës Lindja e Afërt mund të shpallet zonë e çliruar nga armët për shkatërrim masiv dhe mjeteve të tyre dërguese;
21. Kërkon qasjen nga ana e të gjitha shteteve drejt Konventës së Otavës për ndalimin e përdorimit, deponimit, prodhimit dhe transferimit e minave kundër këmbësorisë dhe shkatërrimin e tyre, si dhe të Protokollit II të ndryshuar të Konventës për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të caktuara konvencionale të cilat mund të konsiderohen si të rrezikshme shkatërruese ose të kenë efekte indiskriminuese;

22. I fton shtetet palë të Konventës së Otavës të marrin pjesë në nivel të lartë në Konferencën - Pasqyra e parë, e cila duhet të mbahet në nëntor-dhjetor 2004 në Najrobi dhe në të njëjtën të përgatisin dhe të prezantojnë plane nacionale për pastrimin e minave dhe aktivitete për ndihmën e viktimave në vitet e ardhshme;

23. Gjithashtu, fton në qasjen e shteteve në Protokollin kundër prodhimitarisë kundërligjore dhe tregtisë ilegale të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe municioni, si plotësim i Konventës së Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, që të mundësohet fuqizimi i saj;

24. I fton qeveritë që ta rrisin mbështetjen e Agjencisë ndërkombëtare për armë bërthamore (IAEA) dhe të bisedojnë dhe t'i fuqizojnë marrëveshjet e kërkuara gjithëpërfshirëse për mbrojtje si dhe protokollet plotësuese dhe arazhmanet për siguri më të madhe bërthamore;

25. E inkurajon Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe IAEA që të vendosin regjime detale të mbikëqyrjes në të gjitha shtetet për të cilat ekziston dyshimi se kanë programe sekrete për furnizim me armë për shkatërrim masiv, veçanërisht të armëve bërthamore;

26. Më tej i fton të gjitha vendet që t'i intensifikojnë përpjekjet për implementimin e Rezolutës 1540 (2004) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rezolutës 58/48 (2003) të Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, ta parandalojnë përhapjen e armëve për shkatërrim masiv dhe mjeteve të tyre të dërgimit dhe t'i konsolidojnë politikat për ndalimin e transferimit veçanërisht të terroristëve, pajisjeve materialeve dhe teknologjive të cilat mund të shfrytëzohen për zgjerimin e armëve të këtilla;

27. Kërkon nga parlamentet të miratojnë legjislacion i cili do t'i mbajë qeveritë përgjegjëse kur do të lejojnë të bëhet kontrabandë me armë terroristëve dhe grupeve të organizuara kriminele dhe ndalimin e kontrabandës së këtillë;

28. Kërkon nga të gjitha vendet të cilat e kanë nënshkruar Marrëveshjen qielli i hapur që të sigurojnë se e njëjta është zbatuar tërësisht për mbrojtjen nga sulmet e papritura dhe krijimin e besimit të ndërsjellë;

29. I fton parlamentet që të sigurojnë implementimin e plotë të të gjitha kohërave të Marrëveshjes së Antarktikut, Marrëveshjes për ndalimin e platformës për armë bërthamore dhe mjete të tjera për shkatërrimin masiv të thellësisë oqeanike dhe detare nën sipërfaqen e tyre (Marrëveshja për thellësinë detare) dhe Marrëveshja për parimet të cilat mbisundojnë për aktivitetet e shteteve në eksploatim dhe përdorimin e gjithësisë duke përfshirë Hënën dhe trupa tjerë qiellor;

30. Kërkon nga qeveritë që të vazhdojnë me bisedimet multilaterale për miratimin e Konventës, si plotësim i Marrëveshjes për parime të cilat mbisundojnë me aktivitetet e shteteve në eksploatim dhe përdorimin e Gjithësisë duke përfshirë Hënën dhe trupa tjerë qiellor;

31. Kërkon nga Kombet e Bashkuara, që në përpjekjet e veta ta implementojë programin e vet të aktivitetit për ndalimin, luftën kundër dhe çrrënjosjen e tregtisë ilegale me armë të lehta në të gjitha aspektet e saj, të bashkëpunojë ngushtë me UIP, veçanërisht në pikëpamje të Takimit në korrik të vitit 2005, i cili mbahet në çdo dy vjet, për shqyrtimin e Programit për aktivitet;

32. I inkurajon të gjitha trupat rajonal të bëjnë fushatë për zvogëlimin dhe kontrollimin e tregtisë me armë të lehta;

33. E konstaton rolin vital të grave dhe organizatave të grave në arritjen e zgjidhjes së qetë të konflikteve dhe vendosjen e shoqërive dhe familjeve të qeta, të harmonizuara dhe jo agresive, të themeluara në vlerat njerëzore;

34. Mbështet perspektiva alternative për pengimin e konflikteve nga vet rrënja dhe në nivel të bashkësisë dhe kërkon nga të gjitha shtetet të ndërtohen në to nëpërmjet shoqërisë, me dhënien e fondeve të kapshme për organizatat e grave dhe organizatat joqeveritare dhe themelimin e fondit humanitar ndërkombëtar;

35. Rekomandon që Kombet e Bashkuara, veçanërisht Reparti për çështje të çarmatimit, më tej ta forcojnë bashkëpunimin me UIP, veçanërisht në implementimin e Planit aksionar për orientimin e gjinive, i cili është i dedikuar për përforcimin, konsolidimin, informimin dhe orientimin e punës së ardhshme për çarmatim;

36. Gjithashtu, rekomandon që UIP, nëpërmjet anëtarëve të parlamenteve të veta të ngjashme, në mënyrë aktive ta mbështesë implementimin e të gjitha rezolutave relevante të Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit ekonomik dhe social për promovimin e përparimit të barazisë së grave dhe të gjinive, si dhe të Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit për siguri të grave, paqe dhe siguri, duke i marrë parasysh rekomandimet për gratë dhe luftën të cilat janë të përfshira në Platformën e Pekinit për aktivitet e vitit 1995;

37. Kërkon nga parlamentet të sigurojnë, aty ku mund të zbatohet, që legjislacioni të jetë kompatibil me Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, veçanërisht të përfshijë dispozita për sanksionimin e krimeve kundër grave;

38. Kërkon qasje më të madhe të grave në mediumet dhe mjetet për komunikim, ashtu që mesazhi i tyre kundër konflikteve të shpërndahet më gjerë;

39. Rekomandon zhvillimin e iniciativave multikulturore dhe transnacionale-globale dhe rajonale që t'u lejohet grave pjesëmarrje e plotë në pengimin dhe zgjidhjen e konflikteve, me pjesëmarrje aktive të UIP në këtë rol kyç.

ROLI I PARLAMENTEVE NË MBROJTJEN E BIODIVERZITETIT

Rezoluta e miratuar njëzëri nga ana e Kuvendit të 111-të të UIP (Gjenevë, 1 tetor 2004)

Kuvendi i 111-të i Unionit Interparlamentar,

Duke iu referuar:

- Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve 1951;
- Konventës për moçale me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht për zogjtë e ujit (Konventa e Ramserit për moçale) 1971;
- Deklaratës së Kombeve të Bashkuara nga Konferenca për zhvillimin njerëzor 1972;
- Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore 1972;
- Konventës për tregti ndërkombëtare për llojet e rrezikuara të faunës dhe florës së egër 1973;
- Konventës për konservimin e llojeve migruese të kafshëve të egra 1979;
- Themelimit të Grupit punues të Kombeve të Bashkuara për popullata autoktone 1982;
- Kartës botërore të natyrës 1982;
- Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin për detin 1982;
- Projektit ndërkombëtar për resurse të bimëve gjenetike 1983 (e përcjellë me Marrëveshjen ndërkombëtare për resurse për bimët gjenetike 2001);
- Raportit të Komisionit botëror për ambientin jetësor dhe zhvillimin, *Ardhmëria jonë e përbashkët*, 1987;
- Konventës së diverzitetit biologjik 1992;
- Deklaratës së Rios për ambientin jetësor dhe zhvillimin 1992;
- Protokollit të Kartagjenas për mbrojtjen biologjike të Konventës për diverzitet biologjik 2000 dhe
- Planit për implementimin e Samitit botëror për zhvillim të qëndrueshëm, (Plani për implementim nga Johaneshburgu) 2002,

Gjithashtu, duke iu referuar:

- Konventës së Këshillit Evropian për konservimin e botës së egër evropiane dhe habitatet natyrore 1979
- Konventës së Komitetit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për vlerësimin e ndikimit ekologjik në kontekstin transkufitar 1991 dhe Protokolleve të tij për zhvillimin strategjik ekologjik 2003 dhe
- Konventës së Komitetit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrjen dhe qasje në të drejtat për çështje ekologjike 1998;

Duke pranuar se biodiversiteti - variabiliteti në dhe në mes vet organizmave të gjallë dhe sistemeve në të cilat jetojnë - është kyç për ekzistencë në planetë dhe për llojet që e popullzojnë ashtu sikurse njerëzimi din për ato,

Të bindur se kuptimi i përmirësuar publik i termit “biodiverzitet”, sikurse shfrytëzohet në Konventën për diverzitet biologjik do ta zmadhojë përdorimin e tij praktik në disa strategji lokale dhe nacionale për konventën,

Duke dhënë mirënjohje për punën e Unionit Botëror për konservim (IUCN) e dedikuar për detyrën e rëndë të vendosjes së statusit për biodiverzitet global,

Duke pranuar se konventa e biodiverzitetit është parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm, aq më tepër që përpjekjet janë vitale për zbutjen e varfërisë, sigurimin e ushqimit, sigurimin e ujit të freskët, energjinë e masës biologjike, konservimin e tokës dhe të shëndetit njerëzor,

Duke e theksuar rëndësinë për zonat e mbrojtura si rezerva biosferike në arritjen e qëllimeve të Konventës për diverzitet biologjik,

Duke dhënë mirënjohje, në atë drejtim, në rolin e UNESCO-së dhe Programit për biosferë dhe Strategjia e Sevilës për rezervat biosferike në promovimin e mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të biodiverzitetit,

Duke rikujtuar se niveli momental i dëmit të biodiverzitetit paraqet momentin e parë të rëndësishëm të shfarosjes si rezultat i aktivitetit njerëzor, në historinë e Tokës,

Duke pranuar se Konventa për diverzitet biologjik është instrument ndërkombëtar për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të biodiverzitetit,

Duke vërejtur se Konventa e diverzitetit biologjik nuk i bën vështrim qartë arsyeve themelore të dëmit të biodiverzitetit duke përfshirë ndër të tjera rritjen e popullatës dhe modeleve të paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumimit,

Gjithashtu, duke theksuar se kanosjet më të mëdha të biodiverzitetit të cilat rezultojnë nga aktiviteti njerëzor janë humbja e vendbanimeve dhe përkeqësimi i tyre, ndryshimet klimatike, llojet e huaja invazive, eksploatimi i tepërt dhe ndotja,

Të vetëdijshëm se me Konventën e diverzitetit biologjik shtetet kanë të drejta sovrane mbi resurset e tyre biologjike,

Duke theksuar se në kontekstin transkufitar, udhëheqja stabile me resurset natyrore dhe mbrojtjen e biodiverzitetit dhe balancit ekologjik kërkojnë konsultime dhe bashkëpunim dhe koordinim të plotë të përpjekjeve ndërmjet vendeve fqinje, në korniza ligjore të zbatueshme, ndërkombëtare, bilaterale dhe rajonale,

Duke rikujtuar angazhimet e ndërmarra në Samitin botëror për zhvillim të qëndrueshëm dhe Konferencën e gjashtë të palëve nga Konventa e diverzitetit biologjik, për zvogëlimin e dukshëm të shkallës momentale të dëmit të diverzitetit biologjik deri në vitin 2010,

Gjithashtu, duke u rikujtuar veçanërisht në programin për punën e sferave të mbrojtura i miratuar gjatë Konferencës së shtatë të palëve të Konventës për diverzitetit biologjik,

Më tej, duke rikujtuar se mbrojtja e biodiverzitetit doemos duhet të shkojë më larg se përpjekjet për konservim në vendgjarje, në sferat e mbrojtura dhe se përpjekjet e këtilla vetvetiu janë të pamjaftueshme për çrrënjosjen e dëmit në biodiverzitet,

Duke vërejtur se mallrat dhe shërbimet e siguruara me ekosisteme nuk merren parasysh në metodat konvencionale ekonometrie,

Duke rikujtuar paragrafin 44 (r) të Planit për implementimin e Samitit botëror për zhvillim të qëndrueshëm, të dedikuar veçanërisht për përparimin e strategjisë dhe mbështetjes së ndërsjellë ndërmjet Konventës për diverzitet

biologjik dhe politikave dhe marrëveshjeve për tregti ndërkombëtare në Organizatën tregtare botërore,

Duke e pasur parasysh Deklaratën politike, të miratuar më 16 maj 2002 në mbledhjen e nivelit të lartë të Komisionit për ndihmë zhvillimore të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim, për nevojën e integritit të Konventave nga Rio në aktivitetet për bashkëpunim për zhvillim,

Duke përkujtuar hyrjen në fuqi të Protokollit të Kartagjenës për biombrojtjen nga Konventa për diverzitet biologjik,

Edhe një herë duke konfirmuar se ndarja fer dhe korrekte e beneficioneve nga përdorimi i resurseve gjenetike është një nga qëllimet qendrore të Konventës për diverzitet biologjik,

Të brengosur se komercializimi i biodiversitetit mund t'i vazhdojë marrëdhëniet e pabarabarta historike ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim (duke përfshirë këtu edhe vendet me pyje tropikale), *të vetëdijshëm* se Konferenca e palëve nga Konventa për diverzitet biologjik është forum i cili i shqyrton këto çështje dhe mundohet të gjejë zgjidhje të realizueshme dhe të barabarta,

Duke konstatuar se ata të cilët sigurojnë resurse gjenetike dhe njohuri tradicionale kanë mjete të kufizuara me të cilat mund ta ndalojnë keqpërdorimin e tyre nga kooperativat multinacionale dhe se për zgjidhjen e këtyre mungesave, mekanizmat ekzistues doemos duhet të implementohen edhe më tej të zhvilluara, duke përfshirë legjislaturën nacionale, Drejtimet nga BON për qasje deri te resurset gjenetike dhe shfrytëzimin e drejtë dhe të barabartë të beneficioneve nga shfrytëzimi i tyre (të miratuar në Konferencën e palëve nga Konventa për diverzitet biologjik) dhe Marrëveshja ndërkombëtare e resurseve për bimë gjenetike për ushqim dhe bujqësi,

Duke konstatuar se derisa numër i madh i shteteve kërkojnë ndihmë për mbrojtje nëpërmjet masave në vendngjaarje për elemente të diverzitetit të tyre, për shembull, përmes mirëmbajtjes së bankave të farave, vetëm disa (10) deri sot kanë kërkuar shërbime nga Instituti ndërkombëtar për resurse për bimët gjenetike,

Të alarmuar nga fakti për ndikimin drastik të aktivitetit njerëzor mbi biodiversitetin e ujërave të brendshme dhe sistemeve oqeanike të cilat janë jashtë juridiksionit të qeverive të veçanta,

Duke theksuar nevojën për vlerësimin gjithëpërfshirës dhe preciz të ndikimit ekologjik që duhet të zbatohet para se të fillojë çdo projekt i cili mund të ndikojë në biodiversitetin,

Duke pranuar rëndësinë e lidhshmërisë së ngushtë ndërmjet çështjeve për diverzitetin ekologjik dhe zhvillim të qëndrueshëm në sigurimin e jetës së shëndoshë për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme,

Të brengosur se liderët botëror as nuk vendosin prioritet politike përkatëse të biodiversitetit as nuk i financon në mënyrë adekuate organizatat relevante ndërkombëtare siç është Programi për ekologji i Kombeve të Bashkuara (UNEP),

Gjithashtu, të brengosur për mungesën e vetëdijes publike ndërkombëtare nga pasojat e dëmit në biodiversitet për njerëzit në përgjithësi, ndërsa veçanërisht në vendet në zhvillim,

1. I thërret shtetet të cilat ende nuk e kanë bërë atë që ta ratifikojnë ose t'i qasen Konventës për diverzitet biologjik dhe Protokollit të saj nga Kartagjena për biombrojtje si dhe të marrëveshje të tjera për

biodiverzitet dhe marrëveshjeve të miratuara të nivelit ndërkombëtar dhe rajonal;

2. I thërret qeveritë të ndërmarrin aktivitete më efektive për implementimin e Konventës për diverzitet biologjik me qëllim që ta arrijnë qëllimin e vendosur nga Samiti botëror për zhvillim të qëndrueshëm për zvogëlimin e dukshëm të shkallës momentale në dëm të biodiversitetit deri në vitin 2010;
3. I inkurajon qeveritë që në mënyrë efektive t'i implementojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale për biodiversitet dhe për përmirësimin e koordinimit, për realizim më të mirë të qëllimeve të Konventës;
4. Rekomandon që të gjitha shtetet ta ndihmojnë bashkëpunimin ndërmjet vendeve në rajonet e tyre të cilat së bashku i shfrytëzojnë resurset transkufitare, në interes të mbrojtjes së biodiversitetit, nëpërmjet shpërndarjes dhe këmbimit të informatave dhe njohurive për mbrojtjen dhe ruajtjen e resurseve të tilla;
5. Kërkon aktivitet të koordinuar nga vendet të brengosur për mbrojtjen e vendbanimeve natyrore të situara në zonat kufitare, veçanërisht rezervave biosferike transkufitare dhe në pajtim me marrëveshjet multilaterale dhe bilaterale dhe instrumentet obliguese ligjore në të cilat ato janë palë;
6. Kërkon nga këto vende që të njoftohen dhe konsultohen mes vete për projekte të cilat mund të kenë efekte negative në resurset e përbashkëta natyrore dhe të sigurojnë që vlerësimet gjithëpërfshirëse për ndikim ekologjik zbatohen para se të implementohen projektet e këtilla, në pajtim me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë konsultimin dhe evoluimin adekuat publik të ndikimit transkufitar;
7. Kërkon nga qeveritë t'i fokusojnë përpjekjet e tyre në implementimin urgjent të programit të punës të zonave të mbrojtura, për themelimin, deri në vitin 2010 në zonat tokësore dhe deri në vitin 2012 në zonat ujore, të sistemeve nacionale e rajonale, reprezentative, gjithëpërfshirëse të drejtuara në mënyrë efektive dhe ekologjike të zonave të mbrojtura;
8. Rekomandon që qeveritë ta pranojnë, mes të tjerash, shtimin e popullatës dhe modelet e paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumimit, si arsye themelore për dëmin e biodiversitetit;
9. Kërkon nga qeveritë që tu bëjnë vështrim mekanizmave për dëmin në biodiversitet, ndër të tjera, nëpërmjet metodave për hulumtim dhe koordinim për zvogëlimin e dëmit në vendbanime dhe keqësimin e tyre, nëpërmjet përcjelljes dhe eliminimit të llojeve të huaja invazive dhe nëpërmjet shqyrtimit të ndryshimeve klimatike, me implementimin e plotë dhe efektiv të Konventës për diverzitet biologjik, Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike dhe Protokollit të tij Kjoto dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare;
10. Rekomandon që të gjitha shtetet të bëjnë gjithçka për ta mbrojtur biodiversitetin e tyre, duke i shfrytëzuar plotësisht metodat *in situ* dhe *ex situ* ku është e mundur edhe të kërkojnë ndihmë nga Instituti ndërkombëtar i resurseve për bimët gjenetike;
11. I fton qeveritë të ndërmarrin aktivitet më efektiv për implementimin e Konventës së diverzitetit biologjik, nëpërmjet programeve ekzistuese dhe që funksionojnë në mënyrë tematike dhe aktiviteteve ndërresore, nëpërmjet:

- promovimit të qasjes së ekosistemeve, të zhvilluar me Konventën për diversitetin biologjik, si koncept kyç për udhëheqje të integruar të tokës, ujit dhe resurseve jetësore, i cili promovon mbrojtje dhe shfrytëzim të qëndrueshëm në mënyrë të barabartë dhe
- Inkorporimit të qëllimeve të mbrojtjes së biodiversitetit në të gjithë sektorët, duke përfshirë bujqësinë, peshkatarinë, udhëheqjen e pyjeve, ujërat, turizmin dhe transportin;

12. I inkurajon qeveritë që të angazhohen për vendosjen e regjimit ndërkombëtar për qasje të resurset gjenetike dhe ndarjes fer dhe të barabartë të beneficioneve;

13. Gjithashtu, i inkurajon qeveritë për bashkëpunim për mbrojtje të biodiversitetit dhe i fton organizatat ndërkombëtare dhe vendet e zhvilluara që të ndërmarrin aktivitete konkrete për ndihmën në vendet në zhvillim në atë pikëpamje, përmes ndihmës financiare, transferimit të teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve;

14. Kërkon nga qeveritë plotësisht t'i shqyrtojnë, në politikat e tyre tregtare, qëllimet e Konventës për diversitet biologjik dhe Protokollit nga Kartagjena për biombrojtje, duke njohur qëllimin për përkrahje të ndërsjellë të tregtisë dhe marrëveshjeve për mbrojtje ekologjike për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

15. I fton palët dhe qeveritë t'i përforcojnë përpjekjet e tyre në të gjitha nivelet për implementim të plotë të Konventës për diversitet biologjik dhe Protokollit të Kartagjenas për biombrojtje, posaçërisht nëpërmjet ndarjeve të mëdha të resurseve të nevojshme njerëzore, financiare dhe teknike, në vendet e zhvilluara dhe të pazhvilluara;

16. Gjithashtu, i fton qeveritë të zhvillojnë dhe t'i koordinojnë përpjekjet për zvogëlimin e dukshëm të dëmit të biodiversitetit në hapësirat oqeanike dhe detare të cilat janë jashtë juridiksionit nacional;

17. Më tej, i fton parlamentet për ndërmarrjen e aktivitetit të dedikuar për:

- Vlerësimin e beneficioneve ekonomike dhe financiare për udhëheqje stabile me ekosistemet, me qëllim të inkorporimit të vlerave ekonomike dhe sociale të mallrave dhe shërbimeve të siguruara me biodiversitetin në vendimet të cilët përfshijnë financa publike, politikë, planifikim dhe udhëheqje me resurset natyrore;
- Zhvillimin e stimuleve adekuate dhe të veçanta ekonomike dhe sociale për secilin shtet për avancimin e shfrytëzimit të mbrojtur dhe të qëndrueshëm të biodiversitetit, duke pasur parasysh faktorët lokal të cilët ndikojnë në biodiversitetin;
- Eliminimin ose zvogëlimin e politikave dhe praktikave të cilat prodhojnë stimule të cilat e dëmtojnë biodiversitetin ose e keqësojnë;

- Sigurimin e qëllimeve të Konventës për diversitet biologjik janë të integruara në programet dhe politikat nacionale të sektorit dhe të ndërsektorit;
- Bashkëkohëzimin dhe zhvillimin, ku është e nevojshme në kornizës ligjore dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;
- Promovimin e mekanizmave të nevojshëm të cilët mundësojnë pjesëmarrje nga asociacionet e shoqërive qytetare dhe grupeve të veçanta interesante në procesin e vendosjes për biodiversitetin;
- Rritjen e dijes, të kuptuarit dhe vetëdijes, te shoqëria qytetare dhe te vendim marrësit, për marrëdhëniet ndërmjet shfrytëzimit të mbrojtur dhe të qëndrueshëm të biodiversitetit nga njëra anë dhe rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale nga ana tjetër;

18. Obligohet të zhvillojë bashkëpunim interparlamentar si mjet për promovimin e partneritetit ndërkombëtar për përkrahje të mbrojtjes efektive dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të biodiversitetit në botë;

19. Propozon themelimin e komisioneve speciale për çështje ekologjike në parlamentet në të cilat komisionet e këtilla ende nuk ekzistojnë, të cilët do ta shqyrtojnë mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;

20. I fton qeveritë ta forcojnë kapacitetin e ambientit jetësor global;

21. Rekomandon qeveritë të ndjekin dhe të informojnë për përparim në realizimin e qëllimit për vitin 2010 për zvogëlimin e dëmit në biodiversitet;

22. I fton qeveritë të promovojnë qeverisje koherente ndërkombëtare ekologjike, duke përfshirë bashkëpunimin e rritur dhe harmonizimin ndërmjet organizatave, programeve dhe konventave relevante, me qëllim që t'i ikë palosjes dhe arrijtes së sinergjive.

PEKING +10: EVALUIMI NGA PERSPEKTIVA PARLAMENTARE

Rezoluta e miratuar me konsensus* në Kuvendin e 111-të të UIP (Gjenevë, 1 tetor 2004)

Kuvendi 111 i Unionit Interparlamentar,

Duke e pranuar rëndësinë fundamentale të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, Protokollin e saj alternativ dhe Deklaratën për eliminimin e dhunës kundër grave dhe instrumentet tjera regjionale, duke e përfshirë Konventën interparlamentare për preventivë, dënim dhe çrënjosjen e dhunës kundër grave,

Duke konfirmuar Deklaratën dhe Platformën për aksion të miratuara në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë të mbajtur në Pekin në shtator 1995 dhe dokumentin i cili doli prej saj, e miratuar nga Sesioni special i Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Gratë 2000, barazim gjinor, zhvillim dhe paqe në shekullin 21 (Pekin +5),

Duke e pranuar natyrën gjithëpërfshirëse të Deklaratës nga Pekini dhe Platformën për aksion dhe 12 lëmi kritike, të lidhura me statusin social, kulturor, ekonomik dhe politik të grave në tërë botën,

Të vetëdijshëm për planet nacionale të aksionit të 119 vendeve anëtare të KB, në të cilat është vënë përparim i qeverive në implementimin e angazhimeve të theksuara në Konferencën në Pekin,

Duke konfirmuar Deklaratën e Mileniumit të KB dhe Qëllimet zhvilluese të Mileniumit të përmbajtura në të, posaçërisht qëllimi për barazi gjinore dhe emancipim të grave, pa të cilën zhvillimi nuk mund të jetë i qëndrueshëm dhe, gjithashtu, duke nënvizuar se implementimi i Platformës për aksion nga Pekini është parakusht themelor për përmbushjen e Qëllimeve zhvilluese të Mileniumit,

Duke përkujtuar paragrafin 4 nga Deklarata Universale për demokraci të UIP (1997) e cila thekson "arritje të demokracisë nënkupton partneritet të vërtetë në mes burrave dhe grave në udhëheqjen e punëve në shoqëri në të cilat ato punojnë në kushte të barazisë dhe komplementaritet, duke shterë pasurinë e përbashkët nga dallimet e tyre",

Duke përkujtuar Planin për aksion të UIP për korrigjim të mosbaraspeshës ekzistuese në pjesëmarrjen e burrave dhe grave në jetën politike, e miratuar nga Këshilli Interparlamentar (Paris, mars 1994) dhe Deklarata Parlamentare, e miratuar nga pjesëmarrësit e Ditës së parlamentarëve, mbajtur në Konferencën e Katërt Botërore të Grave,

* Pas miratimit të Rezolutës, Deklarata e Indisë, duke theksuar se e përkrah Rezolutën, shprehi rezervë për terminin "siguria njerëzore", që figuron si nëntitull. Sipas saj kjo ende është koncept i errësuar për të cilin nuk ekziston deficion ndërkombëtar i pranuar.

Duke i përsëritur rezolutat e rëndësishme të KIP, veçanërisht

- Arsimimin dhe kulturën si faktorë themelorë në promovimin e burrave dhe grave në jetën politike si parakushte për zhvillimin e popujve (Havanë, prill 2001);
- Promovimin e respektimit dhe mbrojtjen më të madhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi, e veçanërisht për gratë dhe fëmijët (Pekin, shtator 1996);
- Aksionin parlamentar për qasjen dhe pjesëmarrjen e grave në strukturat e vendimmarrjes me qëllim të arritjes së barazisë për gratë (Madrid, prill 1995) dhe
- Politikën për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe fëmijëve (Pjonjang, maj 19991),

Duke nënvizuar rolin fundamental të grave në të gjithë sektorët e shoqërisë,

Duke bërë vërejtje se dhjetë vjet pas Konferencës në Pekin, gratë edhe më tej përfaqësohen në mënyrë të pamjaftueshme në strukturat e vendosjes në parlamentet, qeveritë, administratën publike, organizatat ndërkombëtare, sistemet juridike dhe ekonomi, dhe se pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave në pozitave në pushtet, urgjentisht është e nevojshme nga arsye të të drejtave të njeriut, drejtësisë, legjitimitetit demokratik dhe efikasitetit në politikën publike,

Është trishtuese që dhjetë vjet pas Konferencës në Pekin, barazia efektive e gjinive është larg realitetit: gratë edhe më tej janë më pak të paguara për punën nga vlera e barabartë, më shpesh se burrat janë viktimë e varfërisë dhe papunësisë dhe më shpesh janë objekt i dhunës dhe tmerrit për arsye të diskriminimit me të cilin përballen vajzat në sferën e arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit personal,

Shumë të brengosur për shkak të nivelit të dhunës kundër grave, duke përfshirë edhe dhunën familjare duke llogaritur këtë si çështje kryesore në luftën për mbrojtjen e grave, barazinë e gjinive, emancipimin e grave dhe të drejtat e njeriut,

Duke vërejtur se Mbledhja e 49-të e Komisionit për statusin e grave pranë KB, e cila duhet të mbahet në vitin 2005, është ngjarje e rëndësishme për shqyrtimin dhe vlerësimin e dhjetëvjetorit pas Konferencës në Pekin,

Duke theksuar rolin thelbësor të parlamenteve dhe të deputetëve në promovimin e barazisë gjinore përmes funksionit legjislativ, buxhetor dhe politik dhe mobilizimin e tyre në mendimin publik dhe përkrahje,

Masa për forcimin e aksionit parlamentar në këto sfera

1. E konfirmon pozitën e vet për qëllimet e theksuara në Platformën për aksion nga Pekini dhe i fton gratë e burrat deputetë të përpiqen për forcimin e aksionit parlamentar me qëllim të arritjes së barazisë ndërmjet gjinive në nivel nacional dhe ndërkombëtar, dhe të ndjekin përparimin e realizimit të përpjekjeve nga Konferenca në Pekin;
2. Rekomandon që deputetët të jenë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në mbledhjen e 49 të Komisionit për statusin e grave pranë KB, e cila duhet të mbahet më 28 shkurt deri më 11 mars 2005 në Nju-Jork, në të cilën do të shqyrtohet implementimi i Platformës për aksion nga Pekini dhe dokumenti i Mbledhjes Speciale të Kuvendit të Përgjithshëm të KB të mbajtur në vitin 2000;
3. I fton parlamentet t'i shtojnë përpjekjet për arritjen e qëllimeve zhvillimore të Mileniumit, përfshirë promovimin e gjinive të barabarta, emancipimin e grave dhe zvogëlimin e shkallës së mortalitetit të lehonave;
4. I fton parlamentet të mbajnë debat për statusin e implementimit nacional të Platformës për aksion nga Pekini para Mbledhjes së 49 të KB -Komisioni për statusin e grave, duke lejuar input adekuat nga organizatat e grave dhe OJQ i fton parlamentet nga vendet që edhe më tej nuk kanë parashtruar përgjigje Pyetësorit dërguar qeverive për implementimin e Platformës për aksion nga Pekini (1995) dhe Rezultatit nga Mbledhja e 23-të Speciale e Kuvendit të Përgjithshëm (2000) t'i hulumtojnë arsyet për këtë vonesë dhe t'i angazhojnë qeveritë t'i prezantojnë përgjigjet e tyre sa është e mundur më shpejt dhe më tej i fton parlamentet të mbajnë debat për rezultatet nga Mbledhja e Komisionit të KB për statusin e grave me qëllim që të sigurojnë vazhdimësi adekuate parlamentare;
5. Rekomandon të ketë prezencë më të madhe të grave në strukturat e vendosjes në kuadër të parlamenteve nacionale dhe forumet ndërparlamentare, si dhe përfaqësim të barabartë nacional në marrëdhëniet me parlamentet e huaja edhe në nivel bilateral dhe multilateral;
6. I inkurajon parlamentet që të luajnë rol aktiv dhe pozitiv në promovimin e barazisë së gjinive edhe në implementimin e masave drejtuar kah prezantimi i barazisë gjinore, përmes krijimit të komisioneve parlamentare për barazi gjinore, të përbërë nga burrat dhe gratë, duke shfrytëzuar mjetet për analizën e buxhetimit të gjinive, duke siguruar integrimin e gjinive në të gjitha vendimet dhe ligjet dhe ndarjen e resurseve të mjaftueshme për këto aktivitete;
7. I porosit parlamentet të luftojnë për përfaqësim dhe pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në punën e tyre dhe të rritet numri i grave në komisione, duke pasur parasysh qëllimin për 50% në pajtim me

dokumentin e miratuar nga Mbledhja Speciale e Kuvendit Përgjithshëm të KB, Gratë 2000: Barabarësia e gjinive, zhvillim dhe paqe në shekullin 21 (Pekin+5), ose së paku 30%, kështu që gratë do të mund të sjellin ndryshime në qasjet e përgatitjes së legjislaturës, dhe gjithashtu, por jo edhe vetëm, të ndërtojnë horizonte të ndryshme dhe kujdes;

8. E thekson nevojën për përforsimin e ekspertizës gjinore për përkrahje dhe për sigurimin e këshillave për deputetët dhe trupat parlamentarë për zhvillim dhe iniciativa të qëndrueshme për barazi gjinore;

9. I fton deputetët të luajnë rol më aktiv në procesin e integritimit gjinor në të gjitha sferat e jetës;

10. Më tutje i inkurajon parlamentet nacionale, e përmes tyre dhe qeveritë që në kuadër të përpjekjeve sistematike për integrim gjinor, të sigurohen se të gjitha qeveritë dhe programet analizohen nga perspektiva gjinore, p.sh. përmes përdorimit të deklaratave me ndikim gjinor për ligjet e propozuara dhe, gjithashtu i fton ligjdhënësit të miratojnë praktikën e shqyrtimit të tërë legjislaturës, duke përfshirë edhe buxhetin, nga perspektiva gjinore dhe për këtë qëllim të sigurohet grumbullimi i të dhënave në lidhje me gjinitë, analizimin e tyre dhe përdorimin si referenca në përgatitjen e politikës dhe punëve ligjvënëse;

11. I fton deputetët që, si kontrollorë të qeverive të tyre, të sigurohen se përpjekjet ndërkombëtare respektohen dhe zbatohen, posaçërisht ato të cilët përfshihen në Konventën për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe protokollit alternativ;

12. I fton të gjithë deputetët, burra dhe gra të krijojnë lidhje të forta ndërmjet mekanizmave ekzistues institucionalë të cilët punojnë për të drejtat e grave dhe OJQ, duke përfshirë organizatat e grave, me qëllim që të gjenden zgjidhje noviteti për problemet e barazisë gjinore;

Duke vështruar sferat e veçanta brengosëse

Sfera politike

13. I fton shefat e shteteve dhe qeverive, si dhe figurat udhëheqëse në partitë politike që fuqimisht dhe publikisht të angazhohen për barazinë gjinore dhe çështjet e gjinive t'i vënë në listën e prioritetëve të përhershme;

14. Më tutje i fton liderët ta rrisin numrin e grave për pozicione në vendimmarrjen në të gjitha nivelet, me qëllim të sigurimit të zhvillimit demokratik në të gjitha shtetet;

15. I fton deputetët që ta ndryshojnë konstruksionin social të roleve të veçanta gjinore me qëllim të përmirësimit të politikës për gratë dhe burrat;

16. Fuqimisht i fton deputetët që ta promovojnë prezencën më të dukshme të grave në partitë politike dhe në miratimin e vendimeve në të gjitha nivelet përmes miratimit, p.sh. të kuotës së sistemeve ose formave të tjera për

aksion afirmativ, gjithashtu, i fton komisionet parlamentare të bëjnë anketa publike që të përcaktohet pse gratë janë të përfaqësuara sa duhet në politikën zgjedhore dhe të miratojnë rekomandime për qeveritë e tyre;

17. E thekson nevojën për sigurimin e qasjes së tërësishme dhe të barabartë të grave në arsimimin qytetar, informimin dhe stërvitjen si votues dhe kandidatë dhe nevojën për luftë kundër qëndrimeve negative shoqërore të cilat i pengojnë gratë për pjesëmarrje në politikë;

18. Kërkon nga qeveritë ta përcaktojnë dhe të shpallin qëllime konkrete vjetore për ministrat dhe administratorët në kuptim të avancimit dhe aftësimit të grave dhe në kuptim të implikimeve gjinore në politikat dhe programet dhe të japin raport vjetor dhe publik se si këto qëllime janë realizuar;

19. E thekson nevojën e krijimit të klimës më të volitshme për gratë në parlamente përmes hulumtimit dhe atje ku është e nevojshme, revizion të rregullores dhe rregullave për shqyrtim dhe të vendoset kodeks i ndjeshëm gjinor të sjelljes dhe e inkurajon zhvillimin e orarit të punës i cili më tepër vëmendje do t'i kushtojë familjes;

20. Kërkon që parlamentet ta marrin parasysh çështjen për përgjegjësi politike dhe obligimet familjare të grave dhe burrave dhe t'i sigurojnë kushtet e nevojshme dhe përkrahje për pajtimin e të dy roleve;

21. E inkurajon zhvillimin e programeve për aftësimin e gazetarëve dhe të të punësuarve të tjerë në mediumet për paraqitjen stereotipe të grave dhe burrave, si dhe vajzave dhe djemve;

Në sferën e ekonomisë

22. I fton parlamentet nacionale të sigurojnë se ligjet nacionale u mundësojnë edhe grave të marrin pjesë në ekonomi në kushte të barabarta sikur burrat, për shembull, me tatimin e të ardhurave dhe përmes garantimit se gratë lirisht mund të blejnë, shesin dhe të trashëgojnë pronë, të posedojnë dhe të udhëheqin me subjekte afariste dhe të kenë qasje te huat;

23. E pranon Qëllimin për zhvillim në mileniumin e ri të Kombeve të Bashkuara për përgjysmimin e varfërisë deri në vitin 2015 dhe i porosit qeveritë të bëjnë gjithçka që është në mundësi të tyre të sigurojnë se nevojat specifike të grave do të merren parasysh në formulimin e strategjive për zvogëlimin e varfërisë;

24. I inkurajon qeveritë dhe organizatat ndërqeveritare, si dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, ta promovojnë pavarësinë e grave sipërmarrëse në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përmes sigurimit të mikrokredive dhe ndihmës tjetër financiare;

25. I fton parlamentet të miratojnë legjislativë adekuate, masa buxhetore dhe fiskale për përmirësimin e baraspeshës ndërmjet punës dhe

familjes dhe të sigurojnë se në mënyrë të mjaftueshme kanë qasje kapacitetet për përkujdesje të fëmijëve;

26. I fton parlamentet dhe qeveritë që ta promovojnë barazinë ndërmjet grave dhe burrave në bazë të masave plotësuese si vijon:

. miratimit dhe sigurimit të implementimit efektiv të ligjeve gjithëpërfshirëse antidiskriminuese;

- garantimit për qasje të barabartë të mundësitë për arsimim dhe trajnim të grave dhe vajzave;
- ndihmës grave për fillim të biznesit;
- garantimit të qasjes së barabartë në tregun për punë të grave dhe burrave;
- garantimit të rrogave të barabarta për punë me vlerë të barabartë;
- promovimit të partneritetit ndërmjet gjinive duke shfrytëzuar përpjekje relevante për informim të publikut siç është në shkolla dhe medime;
- miratimit të normativës për zgjidhjen e çështjeve të gjinive, ndërmjet tjerash, dhe të sigurohet barazia gjinore dhe përfaqësimi i barabartë në nivel të menaxhimit dhe në këshillat e drejtorëve në sektorin privat;
- mundësimin dhe përkrahjen e autorizimit të grave në mjediset rurale dhe nevojat e tyre specifike;

Sigurimi njerëzor

27. E thekson nevojën që parlamentet dhe qeveritë të sigurojnë mbrojtje për të gjithë nga të gjitha kërcënimet për ekzistencën e tyre, dinjitetin dhe mënyrën e jetës, veçmas në formë të varfërisë, urisë, dhunës, eksploatimit seksual dhe tregtisë jolegale me njerëz, konfliktit të armatosur, sëmundjeve ngjitëse duke përfshirë HIV/SIDA dhe mungesën e qasjes në arsim;

28. Fuqishëm e përkrah dhe nxit implementimin e mëtejshëm të reformave nacionale për zgjerimin e qasjes së grave dhe vajzave në programet për arsimim dhe shkrim-lexim, të sigurohet e drejta dhe qasja të shërbimet e riproduktivitetit dhe shërbimet për mbrojtje shëndetësore seksuale, zvogëlimi i varfërisë dhe lufta kundër të gjitha reformave të dhunës kundër grave dhe vajzave nga ana e burrave, duke përfshirë edhe prostitucionin dhe tregtinë jolegale me njerëz;

29. I fton parlamentet të miratojnë ligj kundër të gjitha formave të dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën shtëpiake, dhunën dhe keqpërdorimin seksual, incestin, eksploatimin seksual, prostitucionin e dhunshëm, vrasjen, përdhunimin sistematik, invaliditetin seksual të grave dhe kriminalitetin kundër grave të kryer në emër të nderit; të sigurojnë se ligjet që i miratojnë i mbrojnë viktimat dhe i dënojnë ata që kryejnë dhunë kundër grave, ta ndjekin implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të tillë dhe të ndajnë mjete për programe qëllimi i të cilit është çrrënjësja e dhunës kundër grave;

30. I fton qeveritë dhe palët në konflikte të armatosura që t'i respektojnë në tërësi normat e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe t'i ndërmarrin të

gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, veçmas t'i vënë fund dhunës seksuale kundër grave dhe vajzave dhe t'i sigurojnë se kryerësit e dhunës së këtillë do të nxirren para gjyqit;

31. I fton qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare dhe regjionale që ta identifikojnë dhe gjykojnë përdorimin e praktikës sistematike të dhunës dhe formave tjera të sjelljes jonjerëzore dhe degraduese ndaj grave si instrument i qëllimshëm i luftës dhe pastrimit etnik dhe të ndërmarrin hapa që të sigurojnë se viktimave do t'u jepet ndihmesë e plotë për keqpërdorimin e këtillë për rehabilitimin e tyre mental dhe fizik;

32. E thekson përgjegjësinë e të gjitha shteteve që t'i vënë fund mosdënimit dhe t'i nxjerrin para gjykatës ata që janë përgjegjës për gjenocid, krim kundër njerëzimit dhe krime lufte, duke përfshirë edhe ato në lidhje me krimin seksual kundër grave dhe vajzave;

33. I inkurajon qeveritë që të mendojnë për ratifikimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare për tregti jolegale me njerëz, duke përfshirë edhe Protokollin e vitit 2000 për preventivë, pengim dhe dënim të tregtisë ilegale me njerëz, veçmas me gra dhe fëmijë, që është plotësim i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, t'i identifikojnë faktorët të cilët inkurajojnë tregtinë jolegale me gra, ta rritin bashkëpunimin ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit që t'i shpartallojnë rrjetet e tregtisë jolegale dhe të ndajnë mjete për rehabilitimin e viktimave të tregtisë jolegale në shoqëri;

34. I inkurajon mediumet që t'i rritin njohuritë dhe informimin e publikut për të drejtat njerëzore të grave dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të përkrahin kulturën dhe barazinë gjinore dhe të luftojnë kundër diskriminimit dhe dhunës;

Zgjidhja e konflikteve, pajtimi dhe përtëritja postkonfliktuale

35. Fuqishëm e mbështet Rezolutën 1325 (2000) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gruan, paqen dhe sigurinë dhe i inkurajon të gjitha palët e përfshira që në tërësi që t'i implementojnë rekomandimet e ti;

36. E pranon rolin kyç të grave si edukatore për paqen dhe ato që kujdesen për familjen dhe bashkësitë në preventivën, zgjidhjen e konflikteve dhe pajtim dhe fton në pjesëmarrjen e tërësishme dhe të barabartë të tyre në zhvillimin e institucioneve demokratike pas ndërprerjes së konflikteve dhe gjatë proceseve të përtëritjes, me qëllim që të sigurohet ndërtimi i paqes së qëndrueshme, në bazë të respektit të ndërsjellë, diversitetit kulturor dhe barazisë gjinore;

Për vajzat

37. Fuqishëm i fton të gjithë parlamentarët të sigurojnë atje ku nuk zbatohen në mënyrë rigoroze ligjet për mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre që të miratohen legjislatore të tillë dhe i fton qeveritë dhe parlamentet të ndërmarrin masa adekuate, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislaturës t'i vihet fund dhunës kundër vajzave;

38. Fton në fokus të veçantë dhe në kornizë të ndjeshme, për zgjidhjen e problemeve të vajzave nëpërmjet hulumtimit të ndikimit të programeve, ligjeve dhe zgjidhjeve të propozuara ligjore; fton në desegregacion të madh gjinor dhe ndjeshmëri gjinore në lidhje me të dhënat, metodat e hulumtimit; monitorim të arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe punësimit të vajzave dhe monitorim të bashkësive kulturore dhe migrimit dhe rritjes së mëtejme të vetëdijes dhe përkujdesjes të vajzave në të gjitha përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve;

39. Rekomandon që sistemet ndëshkimore të sigurojnë që vajzat delikvente të kundërvajtjeve marrin mbrojtje adekuate dhe se të drejtat e tyre janë të garantuara, duke përfshirë edhe të drejtën e integritetit personal dhe zhvillim personal;

40. E inkurajon UIP që të vazhdojë të punojë kundër gjymtimit gjinital të grave dhe të traditave dhe praktikave të tjera të rrezikshme, me intensitet të zmadhuar;

41. Rekomandon që atje ku akoma nuk ekzistojnë, të themelohen lëvizje dhe organizata të vajzave, sepse ato shërbejnë si rrjete për shkëmbimin e informatave dhe mund t'u kundërshtojnë zakoneve dhe praktikave që janë diskriminuese në raport me vajzat;

Në përgjithësi

42. Rekomandon që marrëveshjet dhe angazhimet ndërkombëtare në lidhje me çështjet e gjinive, duke përfshirë këtu dhe **CEDAW** (Konventën për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit të grave), të jenë të kapshme në mënyrë masive në të gjitha bashkësitë dhe ato të përkthehen në gjuhët natyrore, etnike dhe gjuhët atdhetare;

43. I fton parlamentet e shteteve që akoma këtë s'e kanë bërë, ti ratifikojnë **CEDAW** dhe Protokollin e tij jo obligues dhe e inkurajon IPU të vazhdojë ta promovojë rolin e parlamenteve në procesin **CEDAW** nëpërmjet fushatave për ngritjen e vetëdijes dhe nëpërmjet seminareve;

44. I fton qeveritë, si edhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe UIP që, nëpërmjet sekretariateve të tyre, të mbledhin dhe të distribuojnë të dhëna të mjaftueshme statistikore që të mund ta analizojnë distribuimin e forcës në pikëpamje të gjinive - si në aspektin kuantitativ, ashtu edhe në aspektin kualitativ- dhe t'i ndajnë të gjitha të dhënat statistikore sipas gjinisë, që të mundësojë pasqyrë sipas përfaqësimit të gjinive;

45. I fton parlamentarët që ta inkurajojnë zhvillimin e aftësive të shkathtësive të liderëve dhe që t'i forcojnë partneritetet strategjike për barazi të gjinive në nivel lokal/nacional, regjional dhe ndërkombëtar, që të ruhet perspektiva gjinore në trupat e tyre ligjdhënëse;

46. Detyrohet që nëpërmjet Mbledhjes të grave parlamentare të UIP, ta ndjekë në bazë të rregullt progresin që e bëjnë parlamentet në implementimin të Planit aksionit të Pekinit.